

RAPORT VJETOR
2018



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

RAPORT VJETOR 2018

RAPORT VJETOR

2018

1. Titulli i projektit
2. Drejtuesi i Projektit
3. Kohëzgjatja
4. Buxheti total
5. Buxheti vjetor
6. Institucionet që bashkëpunojnë
 - a. Universiteti Bujqësor i Tiranës
 - b. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
 - c. Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë
 - d. Institucione jashte vendit.
7. Vendi i zbatimit.
8. Personeli i projektit.
9. Argumentimi shkencor i projektit për vitin 2018.
10. Qellimi dhe Objektivat Themelor të projektit.

Objektivi I. Testimi i kultivarëve të rinj të shegës, boronicës, mjedrës.

Objektivi I.1 Testimi për përshtatshmëri të kultivarëve të specieve (mjedrë, boronicë).

Rezultati 1. Studim i përshtatshmërisë së kultivarëve të boronicës dhe mjedrës.

Rezultati 2: Vlerësimi agrobiologjik i kultivarëve të huaj të Shegës.

Rezultati 3: Grumbullimi i kultivarëve të shegës, boronicë, mjedrë.

Rezultati 4: Krijimi i modeleve të kultivimit dhe shfrytëzimi i tyre për material bimor për shtim (mjedrë, boronicë).

Objektivi I. 2: Studimi i mënyrave më të efektshme të shtimit pemëve frutore.

Rezultati 1: Mënyrat tradicionale të shtimit të mjedrës, boronicës, aronia dhe goji bery;

Rezultati 2: Mënyra e shtimit “in vitro” të frutave të pyllit (mjedrës, boronicës, aronia dhe goji bery);

Rezultati 3: Krijimi i një koleksioni në laboratorin in vitro të nënshartesave të pemëve frutore bërthamore

Objektivi: 3. Promovim i produkteve dhe vlerave të kulturave drufrutore në lidhje me shëndetin dhe efektivitetin ekonomik të kultivimit të tyre;

Rezultati 1: Organizimi i Ekspozitës Pomologjike të pemëve frutore.

Rezultati 2: Promovim i Verërave Autoktone dhe Workshop “Zhvillimi i fidanishteve ne Shqiperi”

Rezultati 3: Publikim i rezultateve të studimeve.

Objektivi II: Zbatimi i teknologjive bashkëkohore në kulturat drufrutore

Objektivi: II.1. Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat drufrutore.

Rezultati 1: Monitorim i sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesore në kulturën e ullirit e agrumeve.

Rezultati 2: Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve frutore e hardhi.

Rezultati 3: Marrja e kampioneve dhe kryerja e analizave për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat drufrutore.

Objektivi II. 2: Zbatimi i hallkave teknologjike në parcela mëmë e koleksione.

Rezultati 1: Hartimi i kartave teknologjike sipas kulturave.

Rezultati 2: Hartimi i preventivave të shërbimeve për çdo kulturë.

Objektivi II. 3. Studime në Bazën Eksperimentale Prodhuese.

Objektivi III: Prodhim të qëndrueshëm dhe inovativ, me efektivitet të lartë ekonomik në kulturat e ullirit dhe agrumeve.

RAPORT VJETOR 2018

Objektivi III. 1 Studimi i përshtatshmërisë së kultivarëve më të rëndësishëm të agrumeve ndaj kushteve ekologjike të Bazës Eksperimentale Prodhuese të QTTB Vlorë.

Rezultati 1: Studimi i përshtatjes së kultivarëve të limonit ndaj kushteve ambientale të koleksionit në Bazën Eksperimentale të Shamogjinit

Rezultati 2: Vlerësimi i afinitetit në mes të nënshartesave më të rëndësishme me kultivarët kryesorë të agrumeve.

Rezultati 3: Karakterizimi agrobiologjik i kultivarit Leccino sipas metodikës së COI-it.

Objektivi III. 2: Studime të efikasitetit ekonomike në ullishtari

Rezultati 1: Produktiviteti i prodhimit të ullishteve intensive për vaj me kultivarët e huaj.

Rezultati 2: Vlerësimi i produktit përfundimtar (vaj) të kultivarëve autokton të ullirit në Shamogjin (efiçenca ekonomike).

Rezultati 3: Ndikimi i ujitjes së ullishtes në përmirësimin e treguesve fiziko-kimik dhe organoleptik të vajit të ullirit në kultivarin Leccino.

Laboratori i analizave të ADN-se

Objektivi III.3. Kërkim në fermë. (Kërkimet në Ferme Aneksi 2)

Objektivi III. 4: Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teoriko-praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.

11. Aktivitetet kryesore.

12. Mënyra e divulgimit të rezultateve.

13. Përfituesit nga projekti.

14. Rreziqet eventuale që parashikohen për mosrealizim të objektivave.

15. Tabela e Produkteve.

16. Botime.

a. artikuj problemor.

b. libra për ekstension.

c. buletin shkencor i QTTB Vlore.

17. Pjesëmarrje në Simpoziume, Konferenca etj

18. Aktivitete të zhvilluara.

19. Vizibiliteti.

20. Projekte me BE-ne.

21. Aneksi 1: Studime.

22. Aneksi 2: Kërkime në ferme.


RAPORT VJETOR 2018

Veprimtaritë e QTTB Vlorë



Veprimtari të transferimit të teknologjive;
Veprimtari kërkimi të aplikuar/zhvillimi teknologjik;
Analiza laboratorike dhe shërbime të tjera;
Veprimtari informacioni tekniko shkencor;
Veprimtari kualifikuese e specializuese;
Veprimtari prodhuese të fidaneve.

Detyrat kryesore të QTTB Vlorë



RAPORT VJETOR 2018



Vizioni


Lehtësimi i përdorimit të qëndrueshëm të teknologjive bujqësore dhe shfrytëzimin e burimeve përmes inovacionit teknologjik

Misioni

Të sigurohet kultivim efikas i specieve përmes teknologjive, mjeteve ekonomiqësore, të efektshme dhe ekonomike;



Shtirja gjeografike e veprimtarive të QTTB Vlorë



RAPORT VJETOR
2018

Shpenzime për vitin 2018

Aktikulli buxhetor	Plani fillestar	Plani i ndryshuar	Fakt realizimi
Shpenzime personeli (600+601)	25000000	22550000	21456735
Shpenzime Korrente (602-606)	10200000	10200000	9506415
Investime te brendshme (230+231)	0	0	0
TOTAL Kapitulli 1	35200000	32750000	30963150
Kapitulli 5 Shpenzime nga te ardhurat			
Shpenzime personeli (600+601)	2680000	2680000	2079601
Shpenzime Korrente (602-606)	900000	900000	876627
Total Kapitulli 5	3580000	3580000	2956228
Totali i Programit 04860	38780000	36330000	33919378

RAPORT VJETOR 2018

1. Titulli i projektit: Menaxhimi i resurseve gjenetike pemë frutore, shtimi i materialit bimor, zbatimi i teknologjive bashkëkohore me efektivitet të lartë ekonomik në kulturat dru frutore (pemë frutore, ulli, hardhi e agrume).

2. Drejtuesi i Projektit: Athina Llambro

3. Kohëzgjatja: Janar -Dhjetor 2018

4. Buxheti total: 4400/000 lekë

5. Buxheti vjetor: 4.400.000 lek

6. Institucionet që bashkëpunojnë:

a. Universiteti Bujqësor i Tiranës:

- Departamenti i Hortikulturës
- Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (UBT).
- Departamenti i Agromjedisit (Sektori i të Ushqyerit të Bimëve).
- Instituti i Bujqësisë Biologjike Durrës

b. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore:

- QTTB Fushë-Krujë
- QTTB Korçë

c. Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë:

- DRB Berat
- DRB Shkodër
- DRB Tiranë
- DRB Gjirokastrë
- DRB Vlorë
- DRB Elbasan
- DRB Fier
- DRB Lushnje
- DRB Korçë
- DRB Kukës
- DRB Lezhë

d. Institucione jashte vendit:


CRA Roma- Itali, IVALSÀ Firenze-Itali, CIHEAM Bari-Itali.

7. Vendi i zbatimit:

- Baza Eksperimentale/Prodhuese ne QTTB Vlorë.
- Njësitë administrative dhe fermerët të përcaktuara nga Drejtorite e Bujqesise te Qaeqeve. Parcela demonstrative per Kërkime në fermë, Demonstrime etj..

RAPORT VJETOR 2018

8. Struktura e projektit:



9. Argumentimi shkencor i projektit:

Tendencat e zhvillimit të tregut të frutave imponojnë zbulimin e rrugëve të reja të frutikulturës shqiptare për kulturat që sot paraqesin interes. Është në rritje vëmendja ndaj frutave minore të cilat ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe tregëtimit të tyre me jashtë.

Disa nga kulturat që kanë marrë një rëndësi të veçantë janë shega, boronica, mjedra, lajthia të cilat janë kultivuar shumë pak kryesisht në formë spontane por edhe pse bimë të egra ndodhen pothuajse kudo. Specialistët e Departamentit të teknologjive të pemëtarisë përgjatë vitit 2018 kanë nisur studime për përshtatshmërinë e kultivarëve dhe dhënien e rekomandimeve për përhapjen në zona të ndryshme klimaterike. Metoda të avancuara të shtimit të frutave minore janë zbatuar në laboratorin e kulturave in vitro, ku janë kryer prova të shtimit të tyre.

Ekzistojnë shumë gjenotipe me origjinë vendi, të cilat dallohen për karakteristika të mira prodhuese e cilësore, siç janë shega e Ndroqit, shega Majoshe e Libohovës si dhe disa forma të kultivuara të shegës në zonat veriore të Tiranës, Krujës, Vlorës etj,. Për të qenë bashkëkohor, specialistët e QTTB Vlorë kanë nisur studime të përshtatshmërisë, kërkime në fermë dhe eksperimente aplikative lidhur me kultivimin e shegës.

Gjithashtu një nga problemet në bujqësi është vlerësimi i kultivarëve me origjinë të huaj të ardhura kohët e fundit në vendin tonë për të cilat u ngritën eksperimente për përshtatshmërinë e tyre ndaj ambjenteve të kultivimit.

Zona të reja të studimit dhe ngritjes së eksperimenteve të kërkimit në fermë në institucion kanë qenë Kukës, Mirditë, Korçë. Studimet janë në vitin e parë të rezultateve dhe në vitet në vazhdim do të arrihet në konkluzione dhe këshilla konkrete për fermeret.

Në kushtet e reja të zhvillimit të bujqësisë vend kryesor ka aplikimi i teknologjive të reja të përparuara, për një zhvillim të shpejtë e të qëndrueshëm të frutikulturës. Në këto kushte aplikimi i metodave bashkëkohore në pemët frutore, ulli, vreshtari dhe agrume në veçanti teknikave dhe teknologjive të prodhimit, menaxhimit të tokës dhe mbrojtjes fitosanitare janë domosdoshmëri. Prova të ndryshme të teknikave të shëndetësimit të hardhisë së infektuar nga viruset janë realizuar në laboratorin e kulturave in vitro. Këto prova në vazhdimësi do të japin rezultate të pritshme.

Ulliri zë vend të veçantë në aktivitetin e institucionit dhe për këtë është punuar për teknologjitë e mbrojtjes, kultivimit për realizimin e produkti cilësor. Risi në këtë vit ka qenë zbatimi i protokolleve të analizës së AND-së së ullirit të cilat janë realizuar në laboratorin e ngritur rishtaz të biologjisë molekulare.

RAPORT VJETOR

2018

Gërshtetimi i teknologjive të reja me ato tradicionale për ngritjen e pemishteve, vreshtave, ullishteve e agrumishteve, ruajtjen e pjellorisë së tokës, rritjen e produktit cilësor kanë qene synim i këtij projekti.

Stafi i QTTB Vlorë, sipas specialiteteve ka realizuar detyrat duke krijuar mundësinë e realizimit të projektit të hartuar për vitin 2018.

10. Qëllimi dhe Objektivat Themelor të projektit.

Qëllimi i Programit: Identifikimi, grumbullimi, koleksionimi dhe studimi i germoplazmës së vendit dhe të ardhur, studimi i përshtatshmërisë së kultivarëve dhe orientimin e fermerëve drejt për mbjelljet e reja si dhe sigurim të materialit për shtim të fidanave të kultivarëve të pemëve, ullinjve, agrumeve e hardhive me potencial të lartë prodhues dhe me gjendje shëndetësore të garantuar.

Objektivat themelore të projektit

Objektivi I. Testimi i kultivarëve të rinj të shegës, boronicës, mjedrës. (1.200.000 lek)

Objektivi I.1 Testimi për përshtatshmëri të kultivarëve të specieve (mjedër, boronicë).

Rezultati 1. Studim i përshtatshmërisë së kultivarëve të boronicës dhe mjedrës.

Rezultati 1. Studim i përshtatshmërisë së kultivarëve të boronicës dhe mjedrës.

Boronica, mjedra dhe aronia janë një mundësi për hapjen e prespektivave të reja për bujqësinë e shtrirë në zona malore që, në mënyrë të paevitushme dhe të ndërgjegjshme i afrohet modelit të prodhimit të integruar, peisazhit dhe ndryshimeve të kushteve social-ekonomike.

Këto fruta paraqesin prespektivë të sukseshme të karakterit të fermës bujqësore, për zhvillimin e një sektori që, përveç komponentit produktiv, ka dhe interes agro-turistik, ku duket i nevojshëm sugjerimi për një drejtim shumëfunksional të fermës.

Në kushte të ndryshme pedo-klimatike, mund të jetë një mundësi e artë që të afirmohen vlerat e këtyre frutave si alternativë kultivimi për terrene lokale. Po kaq interesante është e ardhmja e vlerësimit të mikroklimës që krijohet si rezultat i ndryshimeve të relievit.

Këto aspekte sigurojnë arritjen e një vlerësimi sasior dhe cilësor të produktit me një rezultat të kënaqshëm ekonomik të investimeve që do të bëhen në të ardhmen me këto kultura.

Rritja e ndjeshmërisë dhe kërkesave për produkte tradicionale nga konsumatori forcojnë bindjen për prodhimin e këtyre frutave, krahas prodhimeve të tjera.

Metodologjia e përdorur: Në zonat e përcaktuara Kukës, Korçë e QTTB Vlorë, u mbollën fidanët të cilët u siguruan nga QTTB Vlorë. Janë mbjellë 5 bimë për çdo kultivar. Numri i kultivarëve për Mjadrën-3: Polka, Willamette dhe Meeker, për Boronicën-2: Boronica e zezë dhe Boronica e kuqe. Për zonat ku është ngritur studimi është bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë (Kukës) si dhe me QTTB Korçë të cilët nëpërmjet specialistëve të tyre kanë bërë të mundur ndjekjen e studimeve sipas metodikës së përcaktuar.

Për vitin e parë janë marë në studim: Kushtet pedologjike në të cilat janë mbjellë këta kultivarë, fazat e zhvillimit: lulëzimi, lidhja e frutit, pjekja, prekja nga sëmundjet e dëmtuesit, kushtet klimatike: temperaturat minimale dhe maksimale sasia e rreshjeve, si dhe analizat kimike të frutit.

RAPORT VJETOR 2018

Të dhëna të përgjithshme:

Për zonën e Korçës studimi monitorohet nga specialistë të QTTB Vlorë në bashkëpunim me QTTB Korçë, u zbatua në Fshatin Bulgarec të Qarkut Korçë.

Të dhëna mbi klimën: Studimi u ngrit në lartësinë rreth 830 m mbi nivelin e detit dhe karakterizohet nga klimë mesdhetare. Temperaturat gjatë dimrit variojnë nga -10°C . Temperaturat gjatë verës nga $29-30^{\circ}\text{C}$. Vera është e ngrohtë dhe e thatë. Dimri është i ftohtë e me lagështi. Prania e ngricave të tejkzgjatura, nuk janë shumë të ndjeshme këto vitet e fundit

Të dhëna mbi tokën: Toka ku është ngritur studimi është me ekspozicion ndaj diellit me pjerrësi 0% e kulluar, e mbrojtur nga erërat.

Mbjellja: Mbjellja është bërë më datë 17 mars 2018.

Distancat e mbjelljes: Për aronian në distancat 2.5-1.5 me gropa $40 \times 40 \times 40$ cm.

Për boronicën në distancat 1.5×2.5 me gropa 40×40

Për mjedrën në vijë lineare 50-60 cm midis rreshtave 2.5 cm bima nga bima me gropa $40 \times 40 \times 40$ cm.

Treguesit e marë në studim:

- Monitorimi i fenofazave

-Lulëzimi, Lidhja e frutit (data) mbjelljes (fidani i vogel)

-Datat

-Pjekja e frutit

- Të dhëna mbi frutin.

Pesha e frutit.

Të dhëna biometrike.

- Analizat kimike të frutit.

Në këtë zona bimët janë mbjellë në muajin mars. Nuk janë marë treguesit e parashikuar në metodikë për shkak të moshës dhe madhësisë së fidanit. Studimi është në vazhdim.

Foto të parcelës së mbjellë në Bulgarec-Korçë.



Për zonën e Kukësit: Studimi monitorohet nga QTTB Vlorë dhe zbatohet në fshatin Fshat Gr/Caje Kukës në bashkëpunim me specialistin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës-Haxhi Shehu.

RAPORT VJETOR 2018

Të dhëna të përgjithshme.

Të dhëna mbi klimën: Studimi ngrihet në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit dhe karakterizohet me një klimë të ashpër dhe të thatë. Temperaturat gjatë dimrit variojnë nga 0–(-25°C) dhe gjatë verës nga 15 -40°C . Vera është e thatë edhe e nxehtë me pak rreshje ndërsa dimri i ftohtë dhe me reshje (kryesisht në formë bore). Vitet e fundit bora po ja lë vendin shiut dicka jo e zakonitë ku për bujqësinë po ndikon teper negativisht pasi vendi ndodhet i zbuluar dhe ngricat e tej zgjatura po e dëmtojnë bimësinë.

Të dhëna mbi Tokën: Tokat është e lehta gurishtore e cekët e fragmentizuar me ekspozicion lindje-perëndim me një pjerrësi rreth 5% e kulluar dhe e mbrojtur. Në momentin e mbjelljes janë marrë mostrat e tokës dhe është bërë analiza për treguesit e paraqitur më poshtë.

Tabela 1. Analiza e përbërjes mekanike e kimike e tokës ku janë mbjellë frutat e pyllit Çaj Kukës.

Nr	Treguesit e analizuar	Njesia matëse	Rezultatet e Mostres Çaj Kukës
1	Përcaktimi i pH		8.1
2	Përcaktimi i konduktivitetit elektrik K.E.	μS/cm	0.242
3	Përcaktimi i Humusit	%	6.72
4	Përcaktimi i Azotit (N)	%	0.448
5	Përcaktimi i Fosforit (P)	Ppm	58.9
6	Përcaktimi i Kaliumit (K)	mg/100gr	14.8
7	Përcaktimi i Karbonateve (CaCO ₃)	%	1.85
8	Përbërja mekanike (granulometria)		
8/1	Rërë	%	50.4
8/2	Lym	%	33.6
8/3	Argjil	%	16.0

Mbjellja është bërë më datë 10 mars 2018 në gropa të hapura 40 x 40 x 40 cm. Në mbjellje nuk u përdorën plehra kimike por pleh organik i dekompozuar i një viti më parë

Distancat e mbjelljes. Aronian është mbjellë në distancat 1.5-1.5 m. Boronica është mbjellë në distanca 1.5×2.5 dhe mjedra është mbjellë në vijë lineare 50 cm bima nga bima.



RAPORT VJETOR 2018



Foto nga studimi i ngritur në
Çajë të Kukësit

Gjatë vitit 2018 në parcelën e mbjellë me këto bimë janë kryer dhe monitoruar proceset e mëposhtme:

1. Capitja e parë në dt. 20-21 mars 2018 pa përdorur plehra.
2. Prashita e dytë në dt. 2-3 prill 2018 pa përdorur plehra.
3. Prashitja e tretë në dt. 15-16 prill 2018 të shoqëruar me plehra kristalor të tretur paraprakisht në ujë (200 gr në 20 litra ujë duke hedhur 2 litra tretësirë për çdo bimë).

Ujitjet kanë filluar pas datës 20 korrik pasi gjatë gjithë kohës deri në këtë periudhë jemi shoqëruar me rreshje.

Ujitjet janë përsëritur në cdo 10 ditë deri në nëntor për vetë kushtet e motit të thatë që ka pasuar.

Në mjedër ujitjet janë kufizuar për vetë natyrën e bimës.

Për boronicën është vendosur një tel xingato në lartësinë 35 cm duke bërë lidhjen e lastarëve. Tek mjedra kemi vendosur tela çift në lartësinë 60 dhe 80 cm si sistem mbështetës.

Zënja e fidanëve ka qenë si më poshtë:

Në boronicë 100% (nga 11 fidanë janë zënë 11)

Në aronia 100% (nga 10 fidanë janë zënë 10)

Në mjedër 60% (nga 47 fidanë janë zënë 28)

Baza eksperimentale Shamogjin: Vendi ku u ngrit studimi QTTB Vlorë.

Disa të dhëna të përgjithshme.

Të dhëna mbi Klimën Studimi u ngrit në Bazen Eksperimentale Shamogjin Vlorë. Klima e kësaj zone është me dimër të butë e të lagët ku temperatura minimale nuk i kalon 1 grade C dhe temperatura max të dimrit variojnë nga 6-10 C. Vera është e nxehtë dhe e thatë

Bimët janë mbjellë në vazo 10 litër me një përzierje të dheut dhe plehra të ndryshme (mjeder e aronia) ndërsa për boronicën është krijuar në vazo ambjenti acid duke përzier plehun me halat e pishës.

Mbjellja-Mbjellja është bërë më datë 10 mars 2018.

RAPORT VJETOR 2018



Foto nga studimi i ngritur në

QTTB Vlorë



Rezultate;

Për zonën e Kukësit: Numri total i bimeve të mbjelle:

Në boronicë 100% (nga 11 fidanë janë zënë 11)

Në aronia 100% (nga 10 fidanë janë zënë 10)

Në mjdër 60% (nga 47 fidanë janë zënë 28)

Zgjimi dhe çelja e sythave ka filluar në periudhën 30-15/04/2018, duke filluar me aronien, boronicën e në fund mem.

Ecuria e zhvillimit të lastarëve ka qenë si më poshtë:

Për boronicën dhe aronian kemi patur një zhvillim të ngadaltë e shprehur në gjatësinë e lastarëve të rritur rreth 10-12cm.

Për mjedrën zhvillimi ka qenë më i mirë duke arritur lastari deri në një metër në fund të vegetacionit.

RAPORT VJETOR 2018

Lulëzimi: ka qenë vetëm në bimët e mjedrës, ku ka filluar në qershor duke vazhduar deri në fund të muajit. Ka pasur fruta të lidhur që kanë filluar pjekjen nga fillimi i korrikut deri në fillim të muajit gusht.

Lidhja e frutave ka qenë jo në të gjitha bimët por në ato me të zhvilluarat (40 % e bimëve të zëna)

- Prodhimi ka qenë shumë modest (2-3 kokrra për bimë)

- Madhësia e frutave mesatare

- Ngjyra-tipike e kuqe në vishnjë

- Shija -e ëmbël në të afët me aromën tipike të mjedrës

- Rrëzimi i gjetheve ka ndodhur në fund të muajit tetor fillimisht në bimët e boronicës më pas në aronia e me pas mjedra.

Sëmundjet dhe dëmtuesit: Në boronicë kemi patur infeksion nga hiri , vrugu , në aronia dhe mjedër infeksioni shumë i lehtë Janë bërë vetëm 2 trajtime me fungicide.

Për zonën e Korçës: numri total i bimëve të mbjella është si më poshtë: boronicë 10 bime, mjeder 70 bime dhe aronia 15 copë.

Gjendja e bimeve paraqitet e mire.

Numri i bimëve të zëna është:

- boronicë 100% (nga 10 fidanë janë zënë 10)
- aronia 100% (nga 10 fidanë janë zënë 10)
- mjedër 78% (nga 70 fidanë janë zënë 55)

Për vitin e parë të studimit ecuria e bimëve në fushë ka qenë e mirë por duke qenë se janë fidanë në moshë të vogël nuk është aritur te merren treguesit e prodhimit për këtë zonë.

Studimi do të vazhdoj vitin tjetër me marjen e të gjithë treguesve.

Në Bazën Eksperimentale Shamogjin: Janë mbjellë në vazo 10 litroshe: mjedër 60 copë, aronia 15 bimë dhe boronicë 13 bimë.

Gjendja e tyre paraqitet shumë e mire. Nuk ka asnjë mangësi në numrin e bimëve të aronias dhe mjedrës, përjashtuar boronicën ku janë 2 bimë të thara.

Për periudhën e lulëzimit.

Boronica ka lulëzuar në 1-10 Prill në bimët e mbjella në 2018, dhe në datat 20-30 prill, në bimët e mbjella në vazo në vitin 2017.

Në bimët e aronias ka filluar çelja e sythave në muajin mars dhe në 20-25 mars janë shfaqur lulëritë, që kanë vazhduar deri në 10 maj.

Në bimët e mjedrës lulëzimi ka filluar në 15-30 prill.

Bimët e boronicës kanë pasur rritje dhe pjekje të frutave në një periudhë të shkurtër kohe. Frutat e para janë pjekur në fillim të muajit qershor. Në të njëjtën kohë ka filluar pjekjen edhe mjedra e cila ka pasur një periudhë më të gjatë të pjekjes së saj (deri në shtator)

Aronia ka filluar të piqet mbas datës 20 qershor.

- ❖ *Duke qenë se jemi në vitin e parë të studimit prodhimi ka qenë i reduktuar dhe për treguesit e tjerë të prodhimit rezultatet priten të merren në vitet në vazhdim të studimit.*

Rezultati 2: Vlerësimi agrobiologjik i kultivarëve të huaj të Shegës.

Hyrje

Shega është një nga kulturat që në vitet e fundit po merr një përhapje shumë të madhe në të gjitha vendet për shkak të vëmendjes që po i kushtohet për vlerat që kjo bimë ka në shëndetin e

RAPORT VJETOR 2018

njeriut. Edhe në vendin tonë është duke u ndjekur ky trend që në fakt kushtëzohet edhe nga kërkesa e tregut. Shëga tek ne gjendet e kultivuar pothuajse në të gjithë vendin, madje në formë të egër gjendet e përhapur në Veriun e Shqipërisë dhe në vende të tjera edhe në pyjet shkurre. Kushtet ekologjike të territorit shqiptar garantojnë kërkesat e bimës për faktorët klimatik e tokësor të nevojshëm në kultivimin me sukses në rreth 70% të territorit.

Megjithatë, brenda këtij territori të gjerë, ka mjaft zona ku krijohen kushte specifike të kondicionuara nga elementë me ndikim të madh në disa nga treguesit e klimës. Afërsia me detin, zonaliteti vertikal, grykat e lumenjve etj., janë faktorët që më së shumti ndikojnë në regjimin e temperaturave dhe atë të reshjeve. Edhe pse, temperaturat minimale absolute dhe shumica e temperaturave efektive mbi 10°C janë brenda kufijve të lejueshëm të biologjisë së shëgës, tendenca e ndryshimeve klimatike për ngjarje ekstreme më të shpeshta nxjerr në pah domosdoshmërinë e vlerësimit të kushteve të klimës në zona të catuara.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është vlerësimi i regjimit të reshjeve i lidhur me mundësinë e ujitjes. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit në territorin e vendit tonë është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë e me thatësi që mund të zgjatë edhe disa muaj.

Regjimi i ujit në shëgishte është një nga faktorët që ndikon në shtimin e fenomenit të plasaritjes dhe çarjes së frutit. Ky është dhe një nga problemet që ndikon në tregtimin e prodhimit dhe si i tillë është edhe një nga treguesit që kemi vlerësuar në këtë studim.

Faktorët e tjerë si madhësia e fermës, marketingu etj, janë të lidhur ngushtë me drejtimin që i jepet një aktiviteti të tillë dhe janë faktorët që zakonisht nuk janë vlerësuar. Eksperiencat e mjaft fermave në Shqipëri kanë treguar se jo në pak raste investime të bëra në disa kultura, për shkak të sipërfaqeve të vogla në dispozicion, duke mos arritur të kthehen në burimin kryesor të të ardhurave të familjes, të lihen në aktivitete të dorës së dytë ose të abandonohen duke bërë që të mos japin efektivitetin e dëshiruar. Duke studiuar kërkesat e tregut, dinamikën e lëvizjes së çmimit, kultivarët që shkojnë më shumë ose thjesht njohja e varieteteve që kultivohen në fshatrat e zonës në të cilën banojmë, mund të jenë gjithashtu një ndihmë e konsiderueshme në zgjedhjen e kultivarit.

Shtimi i sipërfaqeve të reja nëpërmjet skemave të mbjelljes në nivel ferme të kësaj kulture kanë nxjerrë në pah, domosdoshmërinë e vlerësimit të kultivarëve më të përshtatshëm për të pasur efektivitetin e duhur në kultivimin e saj. Këtij qëllimi i kushtohet ky studim i cili ka filluar këtë vit për të bërë vlerësimin e kultivarëve të rinj të shëgës (që ndoshta kanë qenë prezent edhe më parë në vendin tonë) dhe po gjejnë përhapje në sipërfaqe të konsiderueshme në mbjelljet e reja.

2. Metodologjia e ndjekur

Për realizimin e këtij studimi është ndjekur metoda e evidentimit dhe më pas e vlerësimit të disa prej etapave më të rëndësishme të ngritjes dhe shfrytëzimit të një pemëtoreje.

Puna e filluar që në vitin 2018 me evidentimin e sipërfaqeve më të konsiderueshme të mbjella me shëgë (kryesisht në zonën e Jugut të vendit) dhe ka vazhduar edhe këtë vit duke parë zhvillimin e pemëtoreve dhe evidentimin e zonave të reja.

Krahas saj, është marrë informacion për kultivarët që po shtohen. Pas kontaktit me pronarët e këtyre shëgishteve është proceduar me informacione për ecurinë e zhvillimit të bimëve të reja dhe problematikat me të cilat këta fermerë janë përballur për kultivimin me sukses të kësaj kulture.

Të dhënat e marra janë krahasuar me tregues të zhvillimit dhe prodhimtarisë së shëgëve që ndodhen të kultivuara në zonat e fshatrave ku janë këto shëgishte.

Janë marrë të dhëna për këto tregues:

- Zhvillimin e përgjithshëm të bimëve të reja.

RAPORT VJETOR 2018

- Gjendjen e përgjithëshme të parcelave.
- Ecurinë e frutifikimit dhe të prodhimit (në rastet e shegëve që kanë hyrë në prodhim).
- Cilësinë e frutave (duke bërë dhe analizat e nevojshme laboratorike)
- Nivelin e tregut dhe interesin ekonomik të fermës.

Fermat që ne kemi identifikuar me sipërfaqe të konsiderueshme janë Dukat-Vlorë, Poro të Fierit, Kolonjë-Lushnje ku kemi marrë të dhëna për studimin dhe në sipërfaqe të reduktuara në Skrofotinë-Vlorë, ku janë disa nga kultivarët e huaj dhe të vendit me të cilët janë krahasuar treguesit e kultivarëve të kultivuar në parcelat e tjera. Kemi evidentuar ferma me sipërfaqe të konsiderueshme në Divjak ë investim që tenton të arrijë në 70ha dhe në Mirditë 5ha.

3. Rezultate dhe diskutime

Fillimisht me pronarët e shegishteve janë marrë kontaktet dhe informacionet për madhësinë e fermës, kultivarët, kohën e mbjelljes etj,. Në fshatin Dukat, kemi kontaktuar me Z. Ariz Kapo (njëkohësisht dhe agronom), Z. Esat Kapo dhe Z. Bledar Ferruni, të tre të investuar për kulturën e shegës. Këta fermerë kanë mbjellë kultivarin *Jolly Red*, i importuar nga Italia me karakteristika të cilësuar nga importuesit si një kultivar me fara të reduktuara, i grupit të shegëve të ëmbla, i përshtatshëm për frut të freskët dhe përpunimi industrial. Bimët janë mbjellë në tokë në fund të pranverës 2016 (afate disi të vonshme) dhe kanë pasur zënie të dobët. Kjo ka ndikuar në krijimin e marrdhënieve jo të mira mes importuesit dhe pronarëve të tokës, duke bërë që pjesa e mbetur nga zënia të spostohet në parcela të tjera jashtë Vlorës.

Dy sipërmarrësit e tjerë, Z. Esat Kapo dhe Z. Ariz Kapo, kanë mbjellë edhe kultivarin *Hicaznar*, shegë me origjinë Turke, me frut me shije të ëmbël në majoshe me fara të buta dhe me cipë me ngjyrë të errët në të kuqe.

Parcelat e mbjella me sipërfaqe 2 ha dhe 0.6 ha janë në vitin e tretë pas mbjelljes, kanë zhvillim të mirë dhe një pjesë e tyre ka filluar të prodhojë frutat e parë. Treguesit e frutave do ti paraqesim më poshtë në Tabelën 1.

Në Dukat në bashkëpunim me specialistin e Ektensionit Z. Mefail Haxhiselimi, kemi evidentuar dhe kemi dhënë asistencë edhe parcela të tjera me shegë si ajo e Z.Ferjat Mëhilli e mbjellë në vitin 2017 me kultivarin *Hicaznar*, dhe një fermë më vogël e Z. Adhurim Allushi që ka mbjellë kultivarët *Wonderfull*, *Tivareshë* dhe *Elbasanse* në një sipërfaqe 1 dyn

Ferma tjetër ka qenë ferma e Z. Kosta Bifsha, sipërmarrës i sukseshëm, ka investuar në një tokë 20 ha të marrë me qera në fshatin Poro-Fier, ku ka mbjellë kultivarin *Wonderfull*, dhe ka si destinacion të prodhimit krahas tregun e freskët edhe për industri. Është gjithashtu investitor në fabrikë për nxjerrjen e lëngut të shegës.

Shegët në këtë fermë janë në vitin e pestë për një pjesë të saj, pasi mbjellja është bërë në tre vite. Pjesa më e madhe e tyre kanë hyrë në prodhim, por viti 2018 ka qenë vit jo I mirë pasi reshjet e shiut kanë përmbytur përsëri parcelën që ndodhet në afërsi të lumit Vjosë, duke demoralizuar investitorin. Për shkak edhe të situatës që pasoi me lidhjen e frutave në sasi të reduktuar për shkak të reshjeve të tejzgjatura gjatë periudhës së lulëzimit, parcela në fjalë gati u braktis duke mos pasur shërbimet e nevojshme për zhvillim normal. Gjatë vizitave në këtë pemishte kemi konstatuar se kultivarët e mbjellë edhe në kushte të tilla kanë arritur të prodhojnë fruta me cilësi të mira nga pikëpamja tregtare, me nivel të ulët të frutave të çara..

Ferma tjetër e marrë në studim e Z. Gëzim Gani në Kolonjë-Lushnje, është në moshë 7-vjeçare, e kultivarit *Hicaznar* dhe është shegishte e cila ka hyrë në prodhim të plotë. Nga të dhëna të marra për vitin 2018, edhe këtu prodhimi nuk ka qenë në nivelin e një viti më parë. Shkaku ka qenë periudha e gjatë me rreshje gjatë lulëzimit që pasoi me reduktim të sasisë së frutave të lidhur. Cilësia e frutave të prodhuar ka qenë e mirë dhe ka pasur kërkesë të lartë për to në treg.

RAPORT VJETOR

2018

Në çdo parcelë janë marrë mostra të futave në kohën e vjeljes dhe është bërë analiza e treguesve biometrik e kimik në laborator.

Tabelë 1. Të dhënat e treguesve biometrik dhe kimik të kultivarëve të shegës të mbjella në katër ferma të ndryshme.

Kultivari	Diametri i frutit D/d	Pesha e frutit (gr)	%/ sheqerit	Aciditeti Total %	Raporti sheqer/aciditet
Hicaznar (Dukat)	115/125	630-650	19.8	1.72	11.5
Hicaznar Skrofotinë	135/140	700-730	19.5	1.68	11.6
Hicaznar Kolonjë	140/155	750-850	19.2	1.75	10.9
Wonderfull Poro	120/130	250-280	18.2	1.95	9.33
Wonderfull Skrofotinë	140/160	500-600	18.5	1.5	12.3

4. Konkluzione

Mbi bazën e rezultateve të krahasuara midis kultivarëve dhe për pozicione të ndryshme të të njëjtit kultivar të paraqitur në Tabelën Nr.1, konstatohet se treguesit janë të ndryshëm. Megjithëse fermat ku kemi bërë studimin kanë investuar në teknologji, influenca ndaj tokës dhe klimës ka ndryshime, kanë bërë që treguesit të kenë diferenca. Rezultatet e treguesit të raportit sheqer/aciditet tregojnë se dy kultivarët kanë shfaqur vetitë e tyre pavarësisht fermës ku janë kultivuar. Kultivari Wonderfull ka vlerat më të larta të këtij treguesi se kultivari Hicaznar, vlera që edhe sipas klasifikimit nga Evreinoff (1957), klasifikohet në vlerat e kultivarëve të ëmbël, ndërsa kultivari Hicaznar është kultivar i pozicionuar midis kultivarëve të ëmbël dhe atyre acid.

5. Mesazhe për fermerët

Shega është një nga drufrutoret me rëndësi e cila për shkak të karakteristikave dhe cilësive të saj, të kërkesave të tregut, i japin asaj përparësinë për një përhapje më të gjerë në vendin tonë. Shtimi i sipërfaqeve me shegë kërkon paraprakisht vlerësimin e kushteve klimatike e tokësore për të vlerësuar nëse jemi në një zonë që krijon kushte optimale, apo në një zonë ku mund të “rezikojmë” në rast se mbjellim këtë kulturë. Krahas saj edhe zgjedhja e kultivarit është një nga vendimet më të rëndësishme. Megjithëse në vendin tonë ka një larmi bimësh që zotërojnë cilësi e shije të pranuar nga tregu për këtë frut, ato në treg gjenden përballë frutash të kultivarëve të konsoliduar që ekzistojnë në botë dhe që me cilësitë e tyre bëjnë diferencën ndaj kultivarëve vendas. Kjo ka bërë që investitorët e rinj të kërkojnë kultivarë që janë më konkurrues në treg. Nga ana tjetër investimi i bërë me kultivarë të panjohur apo me material bimor të pakontrolluar mund të ndikojë në konsum energjie e kohe të padëshirueshme.

Përveç kërkesave specifike të kultivarëve, veçorive të tokës dhe klimës së zonës duhet të vlerësohen disa faktorë që zënë një peshë të rëndësishme në efektivitetin e shegës së tillë si, madhësia e tokës, faktorët që ndikojnë në marketingun e prodhimit dhe e fundit për nga rëndësia, kohën që nevojitet për mirëmbajtjen dhe shërbimet e duhura.

Dy kultivarët e shegës, *Wonderfull* dhe *Hicaznar*, të cilët po gjejnë përhapje të madhe edhe në vendin tonë, për vlerat e larta cilësore e tregtare, janë përshtatur mire, kanë shfaqur cilësitë e tyre në vendet ku janë mbjellë dhe përbëjnë kultivarë potencial për mbjelljet e reja.

Figura 1. Zona-Kolonjë

RAPORT VJETOR
2018



Figura 2. Zona- Poro



Figura 3. Zona-Dukat



RAPORT VJETOR 2018



Rezultati 3: Grumbullimi i kultivarëve të shegës, boronicë, mjedër.

Materiali bimor është grumbulluar nga specialistët në zonat e përhapjes së tyre boronica në Pukë e Kukës, Goji berry në Qeparo dhe mjedra në Kosovë. Fidanët e mjedrës, boronicës, aronias dhe Goji berry u mbollën në Bazën Eksperimentale Shamogjin dhe do të shërbejnë si material për shtimin në vitet në vazhdim të këtyre kulturave.

Rezultatet e arritura: Sigurimi i materialit bimor për shtim të kulturave të rralla.



Rezultati 4: Krijimi i modeleve të kultivimit dhe shfrytëzimi i tyre për material bimor për shtim (mjedër, boronicë).

RAPORT VJETOR 2018

Fidanët e mjedrës, boronicës aronias, dhe goji berry u mbollën në vazo 10 litër dhe janë vendosur në Bazën Eksperimentale Shamogjin. Eshtë ndjekur zhvillimi i tyre dhe janë mbajtur shënime mbi fenofazat e zhvillimit të bimëve. Këto fidanë do të shërbejnë si material për shtimin e tyre në vitet pasardhës.

Rezultatet e arritura: Krijimi i fondit të materialit bimor për shtim.

Foto te fidaneve QTTB Vlore.



Objektivi I. 2: Studimi i mënyrave më të efektshme të shtimit pemëve frutore.

Rezultati 1: Mënyrat tradicionale të shtimit të mjedrës, boronicës, aronia dhe goji berry;

Shtimi i boronicës, mjedrës aronia dhe goji berry me mënyrën tradicionale është realizuar në serrën e QTTB. Shtimi është realizuar me copa i goji berry në periudhën e pranverës. Përqindja e rrënjëzimit të copave të vendosura në bango. ka qenë e lartë. Copat e rrënjëzuara janë mbjellë në vazo dhe janë vendosur në serrë. Ky material do të shërbej si matrial bazë për shtimin e kësaj kulture si dhe për ndjekjen studimeve në vazhdim.

Rezultatet e arritura: Përfitimi i bimëve të goji berry të cilat do të shërbejnë si material për shtim në vitet në vazhdim.



Foto. Bime te shtuara te Goji Berry

Rezultati 2: Mënyra e shtimit “in vitro” të frutave të pyllit (mjedrës, boronicës, aronia dhe goji berry);

Në laboratorin in vitro është provuar shtimi i boronicës, mjedrës dhe aronias në terrene të ndryshme ushqyes. Janë mbajtur shënime mbi shkalla e zënies dhe qëndrueshmërinë e tyre. Eshtë monitoruar ecuria e zhvillimit të bimëve në laborator.

- Bimë drufutrore alternative: mjedra, aronia, manaferra, si dhe shega (Haciznar e Wonderfull)

RAPORT VJETOR 2018



Haciznar



Wonderfull



Shege



Manaferrë e zezë



Aronia

Figurë. Bimë minore në kulturë *in vitro*

Rekomandime:

- Shega wonderfull shtohet *in vitro* dhe aklimatizohet në kushte *in vivo* krahasuar me shtimin tradicional. Shtimi *in vitro* i shegës ka interes për qëllime studimore.
- Shtimi i frutave të pyllit (bimë minore) me teknika *in vitro* (mikroshumim)–tendencë alternative e zhvillimit të tregut të frutave me vlera të mëdha ushqimore dhe shëndetësore në luftimin e shumë sëmundjeve kancerogjene.

Rezultati 3: Krijimi i një koleksioni në laboratorin *in vitro* të nënshartesave të pemëve frutore bërthamore.


- Kultura autoktone drufrutore: dardhë e egër dhe mollë e egër (Mollçinë). (Vend – origjina: Malësi e Tiranës)

Kultivimi, shtimi, rrënjëzimi *in vitro* dhe aklimatizimi *in vivo* i nënshartesave drufrutore autoktone: mollë dhe dardhë autoktone

Inokulimi i materialit bimor autokton dhe shtimi *in vitro* në terren ushqyes MS dhe WPM. Aklimatizimi në serrë i bimëve dardhë dhe mollë autoktone.



Dardhe autoktone



Molle autoktone

RAPORT VJETOR 2018

Objektivi 3: Promovim i produkteve dhe vlerave të kulturave drufrutore në lidhje me shëndetin dhe efektivitetin ekonomik të kultivimit të tyre;

Rezultati 1: Organizimi i Ekspozitës Pomologjike të pemëve frutore.

Më 18 Tetor 2018 u organizua aktiviteti tekniko-shkencor "DITA E SHEGËS". Në takim u organizua edhe tavolina e ekspozimit të resurseve gjenetike të drufrutoreve.

Në takim morën pjesë specialistë e fermerë të interesuar për kultivimin e kësaj kulture. Dr. Pjerin Preka ekspert i kësaj kulture trajtoi argumentet e rëndësishme të biologjisë së specit, të karakteristikave më kryesore fiziologjike të saj, problemet e strukturës varietore dhe në mënyrë të veçantë atë të teknikave të kultivimit.



Rezultati 2: Promovim i Verërave Autoktone.

Në muajin Shtator në QTTB u organizua aktiviteti mbi Promovim e Verërave Autoktone.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i kultivarëve autokton të hardhisë dhe shtimi i sipërfaqeve të mbjella me këta kultivarë. Në këtë aktivitet morën pjesë specialistë të Drejtorive të Bujqësisë Vlorë dhe Fier fermer dhe të interesuar të tjerë.

Të ftuar ishin Kryetar i Degustimit të verërave Flori Uka dhe personaliteti i vreshtarisë Shqiptare Hipokrat Fiku. Në këtë aktivitet u degustuan verërat e prodhuara nga kultivarët autokton të hardhisë që ndodhen në koleksionin e QTTB Vlore.

RAPORT VJETOR 2018



Foto. Promovimi i verërave të kultivarëve autokton

Workshop “Zhvillimi i fidanishteve në Shqipëri”



Në muajin Maj QTTB Vlorë organizoi Workshop. “Zhvillimi i fidanishteve në Shqipëri”. QTTB Vlorë më datë 4 Maj organizoi Workshop Ndërkombëtar “Zhvillimi i fidanishteve në Shqipëri”. Në këtë event përshëndetën Drejtoresha e Agjensisë për Zhvillim rajonal znj. Madlina Puka, Zv. Ministri i Bujqësisë z. Dhimitër Kote, Zv. Konsullja e Konsullatës së Vlorës znj. Nicoletta Borsari. Në këtë Workshop ishin prezent vëllezërit Giulio e Alessandro Castriota Scanderbeg trashëgimtarët e familjes së heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skanderbeg. Ishin të ftuar si relator nga Qendra Kërkimore e Frutikulturës (CRA) Roma - Pjerin Preka, Fidanishte “Apice Piante” Itali- Roberto Di Primio, Qendra Kombëtare e Kërkimit (CNR) Lecce- Federica Blando, Instituti i Resurseve Gjenetike, Tiranë - Hairi Ismaili. Workshop u zhvillua në 6 referime të cilat trajtonin administrimin teknik dhe ligjor të prodhimit e tregtimit të fidanëve, shumëzimin e pemëve frutore dhe zgjedhjen e n/shartesave të përshtatshme të tyre, teknikat tradicionale të shumëzimit si dhe metodat e reja siç është rasti i shtimit in vitro të n/shartesave si dhe frutave të rralla. Eksperiencia e qendrës sonë në prodhimin e fidanëve të ullirit dhe agrumeve pasuron teknikat e shumëzimit të këtyre specieveve kaq të rëndësishme për ekonominë tonë. Aktiviteti i fidanishteve shqiptare dhe eksperiencës së tyre në shartimin dhe teknikat tradicionale të shtimit vegetativ rrit informacionin e nevojshëm për prodhuesit dhe kultivuesit e pemëve frutore në përdorimin e teknogjive të përshtatshme në prodhimin e fidanëve. Albert RABETA dhe Rakip ILJAZI dhanë eksperiencën e fidanishtes së tyre në këtë fushë. I ftuar është Giulio Castriota Scanderbeg- trashëgimtar i familjes së Heroit Kombëtar i cili do të njohë specialistët me eksperiencën e fermës së tij në prodhimin e shegës e në mënyrë të veçantë në rrënjëzimin e fidanëve

Rezultati 3: Publikim i rezultateve të studimeve.

RAPORT VJETOR 2018

Publikimi i rezultateve është realizuar në Buletinin e QTTB ne te cilin eshte pasqyruar puna e bërë gjatë vitit 2018.

Rezultatet e arritura: Organizimi i workshopeve dhe seminareve për sensibilizimin e fermerëve dhe specialistëve për problematikat shqetësuese. Formimi teknik i fermerëve është realizuar nëpërmjet aktiviteteve të shumta teknike.

Mesazhet për fermerët: Pjesëmarrje më e gjerë në aktivitetet e organizuara nga QTTB pasi në këto aktivitete trajtohen shumë problematika që ka sot frutikultura shqiptare. Nga specialistë të njohur të fushës do të merni përgjigjet e pyetjeve si dhe asistencë teknike për gjithë kulturat drufrutore.

Objektivi II: Zbatimi i teknologjive bashkëkohore në kulturat drufrutore

Objektivi: II.1. Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat drufrutore

Rezultati 1: Monitorim i sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesore në kulturën e ullirit e agrumeve.

Gjatë periudhës 1 vjeçare është kryer mbajtja nën kontroll e sëmundjeve dhe dëmtuesve në parcelat mëmë e koleksione. Nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të fazave të zhvillimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve është kryer ndërhyrja në momentin e duhur për të parandaluar përhapjen e infeksionit, megjithë problematikat e shtuara për vet kushtet e papërshtashme të motit për këtë periudhë.

Foto Monitorimi i infeksionit në ulli.



Rezultati 2: Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve frutore e hardhi.

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë disponon një koleksion dardhash të moshës 10 vjeçar me 300 bimë të importuara nga Italia. i përbërë nga 5 kultivarë dhe konkretisht; Abate Fetel, Williams, Cocia, Conference dhe kultivarë autoktone

Në sezonin pranveror kur pemët ishin në fazën e lulëzimit, kemi konstatuar dëmtime të masës lulore (nxirje dhe tharje të tyre). Theksojmë se gjatë këtyre 10 viteve janë kryer normalisht të gjitha shërbimet agroteknike të planifikuara dhe nuk kemi konstauar demtime të kësaj natyre.

Me shfaqjen e simptomave u morën masa për kryerjen e trajtimeve me preparate me baze bakri. Ndërkohë është realizuar krasitja duke larguar të gjitha degët e prekura nëpërmjet prerjes 20 cm nën kufirin e prerjes. Gjatë procesit të krasitjes u përdor pastë 5 % e formuar nga një preparat me baze bakri duke dizinfektuar vazhdimisht veglat e krasitjes gjatë punës.

Gjithë masa bimore e dalë nga krasitja është grumbulluar dhe është eliminuar nëpërmjet djegjes. Janë bërë dy krasitje vegetative (prerje të degëve të infektuara 20 cm, nën zonën e infektuar) si dhe 4 sperkatje me Paste bordolezi 20 % duke përdorur dozen 0.8 deri në 1%.

Situata kufizohej mbas ndërhyrjeve por simptomat pas një periudhe kohore shfaqeshin përsëri.

RAPORT VJETOR 2018

Nisur nga simptomat e vërejtura kemi konkluduar se kemi të bëjmë me djegjen bakteriale të dardhës (*Ervinia amylovora*), një sëmundje kjo shumë e rrezikeshme në kulturat farore të pemëve frutore.

Kushtet e këtij viti me një pranverë të lagët por edhe prania e bimëve strehuese që gjenden në rajon është mundësia e parë për përhapjen e bakterit dhe prekjen e dardhave. Janë pikërisht bletët ato që e përhapin infesionin gjatë fazës së lulëzimit.

Në këto kushte nisur edhe nga rrezikshmëria që ka kjo sëmundje kemi kërkuar të verifikohet edhe nga ekspertë me njohuri më të plota për të dalë në një konkluzion më të saktë dhe të vendosim për ecurinë e tyre.

Mesazhi për fermeret: Nese konstatori shenja të sëmundjeve dhe të dëmtuesve në parcelat tuaja duhet të drejtoheni menjehere pranë institucioneve të specializuara për zgjidhjen e tyre.

Rezultati 3: Marrja e kampioneve dhe kryerja e analizave për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat drufrutore.

Në bimët e indentifikuara me simptoma të sëmundjes janë marë kampione të bimëve të prekura nga (*E amylovora*) sipas metodikës së marjes së mostrave (lastarë) dhe janë dërguar pranë laboratorit të Mbrojtjes së Bimëve në Durrës për një ekspertizë më të thelluar e shkencor për ecurinë e tyre.

Në datën 201.11.2018 kemi marë përgjigje nga Instituti i Mbrojtjes së Bimëve ku theksohej se nuk bëhet fjalë për (*E amylovora*) por për (*Pseudomonas syringae.pv.syringae*) Kjo analizë është shoqëruar dhe me masat mbrojtëse për këtë sëmundje. Menjëherë në kulturen e dardhës ka filluar zbatimi i masave për eliminimin e kësaj sëmundje.

Objektivi II. 2: Zbatimi i hallkave teknologjike në parcela mëmë e koleksione. (1.800.000 lek)

Rezultati 1: Hartimi i kartave teknologjike sipas kulturave.

Për çdo kulturë (pemë frutore, ulli, hardhi e agrume) janë hartuar teknologji specifike të cilat janë zbatuar gjatë periudhës 1-vjeçare. Teknologjitë janë zbatuar në drejtim të menaxhimit të kurorës, menaxhimit të tokës, mbrojtjes nga sëmundjet e dëmtuesit, formave të mbajtjes së kurorës etj.

Foto Shërbime në parcela mëmë e koleksione



RAPORT VJETOR 2018



Në ndryshim me vitet e kaluara punimet e sipërfaqes u realizuan nëpërmjet aplikimit të metodës së diskimit. Punimi me disk ka një kosto më të ulët për njësi të sipërfaqes, të lejon që me shpenzimet e planifikuara të kryesh më shumë punime, përmbys shumë mirë plehrat kimike që hidhen në tokë, punon rreth 85 % të sipërfaqes, nuk dëmtohet sistemi rrënjor i bimës, nuk shton barishtet e egra siç ndodh në rastin e frezimit etj.

Gjatë këtij viti u përgatitën dhe u vendosën tabelat orientuese për vendodhjen e koleksioneve , qendrës administrative duke përmirësuar ndjeshëm paraqitjen vizuale të teritorit të QTTB.

Nisur nga nevoja për përmirësimin e sistemit të kullimit u punua për hapjen e kanaleve të ujrave të larta në vresht, ulli dhe pemë frutore.



Rezultati 2: Hartimi i preventivave të shërbimeve për çdo kulturë.

Preventivat e shërbimeve vjetore janë hartuar për çdo parcelë të ndarë sipas kulturave. Në preventiva janë llogaritur punimet me krah, punimet me mekanike dhe si dhe baza e nevojshme materiale për çdo parcelë. Janë hartuar specifikimet teknike për çdo proces pune si dhe lloji e sasia e përdorimit të preparateve kimike .

Në mbështetje të preventivave të hartuar dhe të miratuar, është mbajtur në monitorim gjatë gjithë vitit kryerja e shërbimeve bujqësore nga ofruesi i këtyre shërbimeve. Puna në këtë drejtim ka ecur sipas afateve të përcaktuara dhe situatave të krijuara gjatë vitit 2018. Punimet e planifikuara janë realizuar në afatet e planifikuara dhe me cilësi të lartë. Krahas angazhimit të gjithë stafit për të monitoruar aktivitetet në drejtim të afatit dhe cilësisë së punimeve një ndihmë të madhe në këtë drejtim ka dhënë firma fituese e tenderit të shërbimeve. Furnizimi me bazë materiale në afatet e kërkuara ka bërë të mundur që grafikët e punimeve të realizohen në afatet e përcaktuara.

RAPORT VJETOR 2018

Në ndryshim me vitet e kaluara punimet e sipërfaqes u realizuan nëpërmjet aplikimit të metodës së diskimit. Punimi me disk ka një kosto më të ulët për njësi të sipërfaqes, të lejon që me shpenzimet e planifikuara të bësh më shumë punime, përmbys shumë mirë plehrat kimike që hidhen në tokë, punom rreth 85 % të sipërfaqes, nuk dëmtohet sistemi rrënjor i bimës, nuk shton barishtet e egra sic ndodh në rastin e frezimit etj.

Gjatë këtij viti u përgatitën dhe u vendosën tabelat orientuese për vendodhjen e koleksioneve , qendrës administrative duke përmirësuar ndjeshëm paraqitjen vizuale të teritorit të QTTB. Nisur nga nevoja për përmirësimin e sistemit të kullimit u punua për hapjen e kanaleve të ujerave të larta në vresht, ulli dhe pemë frutore.



RAPORT VJETOR 2018

Objektivi II. 3. Studime në Bazën Eksperimentale Prodhuese.

Aneksin 1. Ka te gjithë Studimet e ketij objektivi (për arsye të materialit shumë të ngarkuar)

Objektivi III: Prodhim të qëndrueshëm dhe inovativ, me efektivitet të lartë ekonomik në kulturat e ullirit dhe agrumeve.

Objektivi III. 1 Studimi i përshtatshmërisë së kultivarëve më të rëndësishëm të agrumeve ndaj kushteve ekologjike të Bazës Eksperimentale/Prodhuese të QTTB Vlorë.

Rezultati 1: Studimi i përshtatjes së kultivarëve të limonit ndaj kushteve ambientale të koleksionit në Bazën Eksperimentale të Shamogjinit.

Në koleksionin e kulturave të drufrutorëve ndodhet dhe germoplazma e agrumeve Kjo germoplazmë përbëhet nga kultivarë të huaj të ardhur nga Italia në vitin 2009 me tre specie Portokall, Mandarinë dhe Limon.

Qëllimi dhe metoda: Gjatë vitit 2015-2016 u bë studimi i përshtatshmërisë në kultivarët e manderinave dhe portokalleve. Në muajin janar 2017 temperaturat në vendin tonë, (përfshirë dhe Jugun e Shqipërisë), zbritën -10-12°C dhe Agrumet në përgjithësi dhe veçanërisht limoni pësuan dëmtime serioze deri në tharje prandaj ky studim u krye gjatë vitit 2018.

Qëllimi i studimit është që të promovojmë kultivarët më të mirë dhe t'ua rekomandojmë fermërve si dhe ti furnizojmë ata me materjal shumezues cilesor.

Për studimin e kultivarëve të Limonit u morrën treguesit e mëposhtëm:

1. **Fenofazat:** gonxhimi dhe lulëzimi, fillimi dhe përfundimi i tyre.
2. **Analizat fizike të frutit:** Peshë e frutit, raporti tul-lëvore, diametri gjatsor dhe tërthor i frutit, sasia e lëngut dhe numri i farave në frut.
3. **Analiza kimike të frutit:** Lënda e thatë, % e sheqerit, aciditeti, pH.

Pasqyra e treguesve fizikë të frutit

Kultivari	N/shartes	Pesha frut/g	Pesha lëvores/g	Peshatul/gr	Raport tul/lev	D/gjatesor	d/tërth	Lëng/ml	Nr. farat
Sfusato Amalfinato	Nerënxë	122.4	36.6	31	0.92	7.72	5.85	52	7
Meyer	Nerënxë	117	33.3	29.2	0.87	7.31	6	60	6.6

Pasqyra e analizave kimike të frutit

Kultivari	N/shartesa	% sheqeri	Lënda e thatë (%)	Aciditeti total	PH
Sfusato Amalfinato	Nerënxë	8.9	13	0.6	2.56
Meyer	Nerënxë	8	14	0.63	2.8

Sfusato Amalfinato

RAPORT VJETOR 2018



Meyer



Konkluzione:

Në kushtet e zonës së Shamogjinit kur temperaturat arritën -12°C, në përgjithësi kultura e limonit nuk ishte rezistente. Qëndrueshmëri të mirë kishte kultivari Sfusato Amalfinato/nerenxë, më pak të qëndrueshëm kultivarët Meyer dhe Interdonato.

Me shërbimet agroteknike që u bënë gjatë gjithë vitit 2017-2018 janë rigjeneruar pjesa më e madhe e bimëve dhe nga 5 kultivarë që janë në koleksion studjuam këtë vit 3 kultivarë, Sfusato Amalfinato, Meyer dhe Interdonato. Kultivari Hibrid Tracle rezultoi të mos jetë mbjellë në koleksion pasi sipas skemës në vend të tij janë mbjellë portokalle. Përsa i përket kultivariëve

RAPORT VJETOR 2018

Lunario dhe Feminello me gjithë shërbimet e bëra ato nuk u rigjeneruan më pas ngricave edhe gjatë vitit 2018 (janë tharë tërsisht)

- a. **Sfusato Amalfinato:** Eshtë kultivari që i rezistoi më mirë ngricave të vitit 2017, nuk pati dëmtime të shkallës së dytë dhe të tretë por vetëm të masës gjethore, ka në tërsi zhvillim të bujshëm.

Ka lulëzim të mesëm por pjekje të hershme, prodhim të mirë, lëng aromatik, pak fara, % sheqeri të lartë dhe aciditet të ulët.

Prekje mesatare nga Tënja minuese dhe Breshkëza


- b. **Meyer:** Siç shihet edhe në fotot e mësipërme limoni Meyer ka zhvillim mesatar.

Nuk ka një periudh lulëzimi por lulezon disa herë në vit. Në çdo periudh të vitit ka lule, fruta të vegjël dhe fruta të rritur. Më pjellor është sezoni i pranverës.

Ka shume leng dhe pak fara.

Prekje mesatare nga tenja minuese, qëndrueshmëri të lartë ndaj breshkëzës.

Interdonato



-Kultivari Interdonato ka qëndrueshmëri mesatare ndaj ngricave.

-Në koleksionin e QTTB-ës është rinovuar pjesërisht (jo të gjitha bimët).

- Ka qëndrueshmëri të lartë ndaj tënjës minuese dhe breshkëzës.

- Gjatë vitit 2018 nuk prodhoi fruta prandaj nuk u realizua tërsisht metodika për këtë kultivarë.

Rezultati 2: Vlerësimi i afinitetit në mes të nënshartesave më të rëndësishme me kultivarët kryesorë të agrumeve. Studimi i mundësisë së përdorimit të tyre në rritjen e përshtatshmërisë së bimëve të agrumeve ndaj kushteve tokësore të terreneve të zonës. Viti i studimit 2017-2019.

Ky studim do të realizohet në bazën e Shamogjinit dhe viti 2018 është viti i dytë i studimit.

Ky studim realizohet në bazën e Shamogjinit dhe viti 2018 është viti i dytë i studimit.

Metodika e përdorur: Janë marë në studim: Përputhshmëria e disa nënshartesave kryesore me kultivarët kryesor të agrumeve. Në studim janë 6 nënshartesa, dy nënshartesa të përdorura tradicionalisht Trifoliata, eNerënxë dhe katër nënshartesa të reja: Rubidox, S. Citrumelo, C. Carizo, C. Troyer.

Janë realizuar: Shartimi në muajin Maj i tre specieve, portokalle, limon dhe manderina mbi nënshartesat Rubidox, S. Citrumelo dhe Nerenxë. Janë marrë treguesit e % së zënies, treguesit e rritjes së fidanit. Janë në proces rritje dy nënshartesat e tjera, C. Troyer dhe C. Carizo të cilat do të shartohen në Maj 2019.

Rezultate e arritura: Shartimet e bëra mbi nënshartesën Nerënxë/ përçindje më të lartë zënie ka Limoni dhe më të ulët Manderina.

-Përsa u përket treguesve të rritjes Limonat kanë diametër të lastarit më të madh, më pas vijnë Portokallet dhe diametër më të ulët kanë Manderinat.

-Nuk ndodh e njëjta gjë me rritjen e lastarit pasi rritje më të madhe kanë Manderinat, më pas portokallet dhe rritje më të ulët të lastarit në gjatësi kanë limonat.

RAPORT VJETOR 2018

- Ajo që vihet re vitin e parë të shartimit në të tre speciet e agrumeve mbi nënshartesën nerenxë është se nuk ka një korelacion të drejtë midis dimetrit dhe gjatësisë së lastarit të çelur.
 - Mbi nënshartesën Rubidox % më të lartë zënie kanë Manderinat dhe më të ulët Portokallet.
 - Përsa i përket diametrit të lastarit të çelur janë Limonat me diametër më të madh, më pas vijnë portokallet dhe Manderinat.
 - Gjatësi më të madhe të lastarit në agrumet e shartuara mbi Rubidox ka Manderina dhe më të vogël Portokallet.
- Keto janë *konkluzione* paraprake të nxjerra nga shartimet e vitit 2018, do vazhdojmë shartimet edhe me nënshartesat e tjera gjatë vitit 2019 dhe konkluzionet përfundimtare do të dalin në fund të vitit të ardhshëm.

Titulli: Vleresimi i afinitetit në mes nënshartesave me të rëndësishme me kultivarët kryesor të agrumeve. Studimi i mundësisë së përdorimit të tyre në rritjen e përshtatshmërisë së bimëve të Agrumeve ndaj kushteve tokësore të terreneve të zonës.

Dihet që nënshartesa duhet ti sigurojë mbishartesës sistem rrënjor të fuqishëm dhe të qëndrueshëm, por nga ana tjetër nënshartesa duhet të siguroj edhe një pajtueshmeri sa më të lartë me mbishartesën, të jetë tolerante ndaj faktorëve të ndryshëm biotik dhe abiotik. Prandaj themi që problem i nënshartesave ngelet aktual.

Qëllimi: Të përcaktojmë për secilën specie Agrume nëshartesën më të mirë përsa i përket përpuethshmërisë në momentin e shartimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të fidanit.

-Tu rekomandojmë fermereve fidana prodhues nënshartesat më të mira për secilën specie dhe gjithashtu fermereve që do të investojnë për të ngritur një agrumishte të re ti orjetojmë drejt kultivarëve më të mirë dhe nënshartesave më të përshtatshme në varesi të kushteve klimatike dhe tokësore ku do të ngrihen plantacione të reja.

Vendi i ngritjes së eksperimentit: Serra e Shumezimit Shamogjin

Periudha e studimit: 2017-2019

Gjatë vitit 2017-2018 sipas metodikës u punua për prodhimin e nënshartesave mbi të cilat do të bwhen provat e përpuethshmërisë së agrumeve. Nëshartesat janë në proces rritje, nuk u zhvilluan të gjitha në standartin për shartim. Këtë vit u kryen shartimet mbi dy nënshartesa, do vazhdojnë provat e shartimeve për nënshartesat e tjera në pranverë të 2019-es.

Në muajin Maj 2018, u shartuan me sythë tw zgjuar tre specie agrume, Portokalle, Manderinë dhe Limon mbi nënshartesën Nerenxë dhe Rubidox.




Gjatë periudhës Qershor-Nëntor u kryen të njëjta shërbime agroteknike për të gjitha shartimet si ujitje, plehrim gjethor dhe në qeskë, shkrifërime, heqje sqetullorë, thithakë dhe spwrkatje çdo javë për të mbajtur në kontroll tenjën minuese.

Një muaj pas shartimit u bë verifikimi zënieve sipas specieve dhe nënshartesës. Në fund të muajit Nëntor u bën matjet biometrike për treguesit e rritjes sipas metodikës (diametri dhe lartësia dalë si mesatare e 30 bimëve të matura) të cilat jepen në tabelën dhe grafikët më poshtë.

1. Nënshartesa Nerënxë



Nënshartes	Specia e shartuar	%e zënies	Diameter lastar të çelur/mm	Gjatësi lastar/cm
Nerenxë	Portokalle	87.7	4.85	25.8
	Manderine	77.5	4.5	27
	Limon	95.2	4.9	20

RAPORT VJETOR 2018



2. Nënshartesa Rubidox

Nënshartes	Specia e shartuar	% e zënies	Diameter lastari të çelur/mm	Gjatësi lastari /cm
Rubidox	Portokalle	56.6	3.7	12.7
	Manderinë	90	3.46	15
	Limon	72	3.9	14.3



RAPORT VJETOR 2018




Foto Shartime ne agrume



Konkluzione:

- Siç shihet nga tabelat dhe grafikët nga shkrimet e bëra mbi nënshartesën **Nerënxë** përqindje më të lartë zënie ka Limoni dhe më të ulët Manderina.
 - Përsa u përket treguesve të rritjes Limonat kanë diametër të lastarit më të madh, më pas vijnë Portokallet dhe diametër më të ulët kanë Manderinat.
 - Nuk ndodh e njëjta gjë me rritjen e lastarit pasi rritje më të madhe kanë Manderinat, më pas portokallet dhe rritje më të ulët të lastarit në gjatësi kanë limonat.
 - Ajo që vihet re vitin e parë të shartimit në të tre speciet e agrumeve mbi nënshartesën nerënxë është se nuk ka një korelacion të drejtë midis dimetrit dhe gjatësisë së lastarit të çelur.
 - Mbi nënshartesën **Rubidox** % më të lartë zënie kanë Manderinat dhe më të ulët Portokallet.
 - Përsa i përket diametrit të lastarit të çelur janë Limonat me diametër më të madh, më pas vijnë portokallet dhe Manderinat.
 - Gjatësi më të madhe të lastarit në agrumet e shartuara mbi Rubidox ka Manderina dhe më të vogël Portokallet.
- Keto janë konkluzione paraprake të nxjerra nga shkrimet e vitit 2018, do vazhdojmë shkrimet edhe me nënshartesat e tjera gjatë vitit 2019 dhe konkluzionet përfundimtare do të dalin në fund të vitit të ardhshëm.

Rezultati 3: Karakterizimi agrobiologjik i kultivarit Leccino sipas metodikës së COI-it.

Qëllimi: Kultivari leccino është kultivarë Italian ardhur në Shqipëri para 30 vitesh. Ka shfaqur cilësi shumë të mira si në përshtatshmërinë e tij në kushtet e vendit tonë po ashtu edhe për

RAPORT VJETOR 2018

prodhimtari të mirë dhe qëndrueshmëri të lartë ndaj semundjeve në tëresi dhe ka rezultuar me rezistent ndaj sëmundjes që kohët e fundit është përhapur në Itali, Xylella Fastidioza. Është e nevojshme që ta studjojmë më në detaje cilësit agrobiologjike të këtij kultivari deri në produktin përfundimtar, vajin dhe ti japim rekomandimet e nevojshme fermerëve.

Metodika që u përdor: Studimi 1-vjecar.

Vendi i kryerjes së studimit: Në ullishten e QTTB, Shamogjin.

Treguesit që u moren në studim:

Kapaciteti Rrënjëzues në % si më poshtë: Shumë i ulët 1-20, ulët 20-40, Mesatar 40-60, i lartë 60-80, Shumë i lartë 80-100.

Fuqia e bimës: Të dhënat u marrën në bimë 8 vjeçare

Sipërfaqja e seksionit të trungut(10 cm mbi tokë) diametri ose perimetri

Volumi i kurorës në m³: - Shumë e vogël < 20, e vogël 20-30, mesatar 30-40, e madhe 40-50, shumë e madhe >50

Sipërfaqja e Kurorës në m²

-Shumë e vogël < 20, e vogël 20-35, mesatar 35-50, e madhe 50-65, shumë e madhe >65

Lulëzimi.

Intesiteti i lulëzimit (ç' pjesë të % te sipërfaqes së kurorës zë): Shumë e ulët 1-20, e ulët 20-40, mesatar 40-60, e lartë 60-80, shumë e lartë 80-100.

Periodiciteti dhe hyrja në prodhim(pas sa vitesh hyjnë në prodhim, vjelja e parë): Shumë e hershëm < 3, - E hershëme 3, Mesatar 4, i vonë 5, shumë i vonë >5.

Pesha mesatare e frutit: Mostra me 50 fruta, klasifikimi: Shumë i ulët nën 2gr, i ulët 2 - 4 gr, - Mesatar 4- 6 gr, i lartë 6-8 gr, shumë i lartë mbi 8 gr.

Pesha mesatare e endokarpit (për 50 bërthama) Shumë i ulët nën 0.2gr, - I ulët 0.2 – 0.4 gr, Mesatar 0.4- 0.6 gr, i lartë 0.6-0.8gr, Shumë i lartë mbi 0.8gr.

Raporti Tul/ Berthamë: I ulët nën 5, Mesatar 5.0 -7.5, i lartë 7.5 – 10, Shumë i lartë mbi 10

Gjatësia e gjethes: E shkurtër nën 5 cm, - E mesme 5 – 7 cm, - Gjatë mbi 7 cm

Gjerësia e gjethes :E ngushtë nën 1 cm, - Mesatare 1 – 1.5 cm, - E gjerë mbi 1.5 cm

Relacioni Gjatesi/ gjerësi (Gj/gj) Eliptike (GJ/gj më e vogël se 4),- Eliptike gjatësore (Gj/gj 4-6),- Gjatësore Gj/gj mbi 6

Forma e frutit: Sferike (GJ/gj nën 1.25), Ovoidal (Gj/gj 1.25-1.45), - E gjerë. (Gj/gj mbi 1.45)

Forma e berthamës: Sferike (GJ/gj nën 1.4), -Ovoidal; Gj/gj 1.4-1.8), -Eliptike (GJ/gj 1.8-2.2), - E gjerë. (Gj/gj mbi 2.2)

% e Lageshtisë: Shumë e ulët nën 40, e ulët 40-50, mesatare 50-60, e lartë 60-70, shumë e lartë mbi 70.

Duke u bazuar në metodikën e mësipërme vlersimi për kultivarin Leccino nga studimi i vitit 2018 është si më poshte:

Kapaciteti rrënjëzues: Nga prova e këtij viti kapaciteti rrënjëzues rezultoi mesatar, por prova të rrënjëzimit do vazhdojmë të bëjmë edhe vitin e ardhshëm.

Sipërfaqja e seksionit të trungut: Perimetri në lartësinë 10 cm është 53cm

Volumi i kurorës: 31.07 m³

Intesiteti i lulëzimit: I lartë, pasi zë 60-80% të kurorës

Periodiciteti dhe hyrja në prodhim: Konsiderohet i hershëm, pasi hyn në prodhim që vitin e tretë.

Karakteristikat e Pemës:

1. Fuqia e bimës: Në kushtet e zonës së Shamogjinit, por në përgjithësi në zonën fushore të Vlorës kultivari Leccino paraqitet bimë me zhvillim mesatar.

2. Shpërndarja natyrale e degëve kryesore –E hapur.

RAPORT VJETOR 2018

3. Densiteti i kurorës: Mesatare, vegjetacin i ndendur me hapsira për dritë.


4. Gjatësia midis ndërnyjeve : Mesatare (2.57 cm, dale nga matja e 8-10 degeve te shperndara)

Përsa i përket peshës dhe treguesve biometrik të frutit, bërthamës dhe gjethes nga matjet e bëra sipas metodikës rezultatet paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr	Kultivar	Fruti			Bërth.			Gjeth					
		D/mm	d/mm	D/d Mm	D/mm	d/mm	D/d mm	Pesha e frut gr.	Pesh. berth gr	Rap T/B	Gjat. cm	gje r cm	Rap Gj/gj
	Leccino	20.03	14.5	1.38	15.8	7.23	2.19	2.8	0.53	5.3	6.28	1.5	3.9

Duke marrë të gjitha të dhënat e mësipërme përpilojmë këtë skedë për kultivarin Leccino

Kultivar Leccino



Volumi kurorës	Mesatar
Fuqia e bimës mesatar	Zhvillim
Shpërndarja natyrale e degëve	E Hapur
Densiteti i kurorës	Mesatar
Gjatësia e ndërnyjeve	Mesatare
Kapaciteti rrënjëzues	Mesatar
Intesiteti i lulëzimit	I Lartë



Fruti	
Pesha	Mesatare
Forma	Ovoidal
Simetria	Lehtësisht asimetrike
Maja	E rumbuakët
Baza	E sheshtë
Cepi i majës	Mungon
Prezenca lenticelas	Nuk ka
Ngjyra në maturim të plotë	E zezë
Bërthama	
Pesha	E lartë
Forma	Eliptike
Simetria	Lehtësisht asimetrike
Maja	Me majë
Baza	Me majë
Nr. i damarëve	I ulët
Shpërndarja	Uniforme
Fundi i majës	Pa cep
Raporti Tul/B.	Mesatar
Gjethja	
Forma	Eliptike
Gjatësia	Mesatare
Gjerësia	E gjerë

RAPORT VJETOR 2018

Objektivi III. 2: Studime të efikasitetit ekonomik në ullishtari

Rezultati 1: Produktiviteti i prodhimit të ullishteve intensive për vaj me kultivarët e huaj.

Titulli: “Produktiviteti i prodhimit të ullishteve intensive për vaj me kultivarët e huaj Koroneiki, Arbequina në zonën e Vlorës”. (Viti i studimit: 2017-2018)

1. Hyrje

Ulliri në vendin tonë, për rëndësinë e tij ushqimore, jo vetëm që është vlerësuar qysh në kohrat më të vjetra, por për të parët tanë, ka qenë e njohur mirë për kohën, edhe teknika e shtimit, e rritjes dhe ajo e nxjerrjes së vajit. Fakti që ne sot trashëgojmë ullin dhe ullishta në numër dhe sipërfaqe të mëdha, nga një e kaluar shumë e largët, tregon se në drejtim të përhapjes së ullirit, në vendin tonë dhe kultivimit të tij me kritere të drejta teknike për kohën, i është kushtuar gjithmonë një rëndësi dhe kujdes i veçantë.

Vitet e fundit mbjellja e ullishteve intensive ka gjetur shtrirje të gjerë në shumë vende të kultivimit dhe kryesisht në kultivarët Koroneiki dhe Arbequina. Ullishtet intensive sot kanë rritje të sipërfaqes së mbjelljes të ullirit në rajonin e Mesdheut dhe më gjerë.

Ky model i mbjelljes së ullishteve është përpjekje e vazhdueshme e punës së fermerit për të rritur sasinë e prodhimit nëpërmjet futjes së shpejtë të ullirit në prodhim dhe rritjes së numrit të bimëve për sipërfaqe duke përshtatur paketa teknologjike për mirëmbajtjen, shkallën e lartë të mekanizimit, ujitjes, ushqimit të bimëve dhe mbrojtjes së tyre nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

2. Metodologjia e përdorur Studimi u ngrit në parcelën e mbjellë me ulli në zonën e Novoselës, Mifolit dhe Trevllazrit (Vlorë), me ullishte intensive për vaj në kultivarët Koroneiki dhe Arbequina për të marrë një prodhim të hershëm me efektivitet të lartë ekonomik dhe me kosto të ulët.

Studimi u krye në periudhën Janar 2017 - Dhjetor 2018.

A. Parcela Novoselë

-Kultivari Koroneiki: Sipërfaqja: 1.2 dyn; Numri i bimëve: 60; Distanca e mbjelljes: 5mx 5m.

-Kultivari Arbequina: Sipërfaqja: 1.4 dyn; Numri i bimëve: 70; Distanca e mbjelljes: 5mx5 m

B. Parcela Mifol

-Kultivari Koroneiki: Sipërfaqja 1.7 dyn; Numri i bimëve: 70; Distanca e mbjelljes: 5m x 4 m.

-Kultivari Arbequina: Sipërfaqja: 2 dyn; Numri i bimëve: 80; Distanca e mbjelljes: 5m x 4 m

Për vitin e dytë të studimit u shtua dhe një parcelë me të dhënat si më poshtë:

C. Parcela Trevllazër

-Kultivari Koroneiki: Sipërfaqja 1dyn; Numri i bimëve: 40; Distanca e mbjelljes: 5m x 5 m

-Kultivari Arbequina: Sipërfaqja: 1 dyn; Numri i bimëve: 40; Distanca e mbjelljes: 5m x 5 m

3. Treguesit e marrë në studim

Prodhimi kg/rr

Përqindja e vajit (%)

Dokumentimi i shpenzimeve (shpenzimet e kyera gjatë vitit)

RAPORT VJETOR 2018



Parcela Mifol-2017



Parcel Novosel-2017



Momente nga Vjelja



Parcela Novosel



Parcela Mifol-2018



Parcela Trevllazër-2018

4. Rezultate dhe diskutime

Për vitin 2018 studimi u krye në tre parcela të veçanta në tre zona të ndara në Mifol, Novoselë dhe Trevllazër.

Për të tre parcelat e marra si provë u monitoruan të dy kultivarët (Koroneiki dhe Arbequina), zhvillimi i bimës gjatë gjithë vitit (kurorë, trungu dhe fruti), u morën sipas afateve të gjitha shërbimet e kryera nga fermeri si shërbimet agroteknike, trajtimet krasitja, ujitja, plehrimet, u morën sipas kohës së pjekjes treguesit e prodhimit (kg/rr), si dhe rrezja e vajit e shprehur në (%). Moshë e pemëve të ullirit të marrë në studim është 6 vjeçar. Në përgjithësi ullishtet e reja intensive në zonën fushore kanë shprehur nivele të ndryshme ekonomike megjithëse kanë qënë në kushte të njëjta të tokës, klimës dhe teknologjisë. Kultivarët Koroneiki dhe Arbequina kanë hyr nga Greqia dhe Spanja, megjithatë ato kanë shprehur indeks përshtatëshmërie të mirë.

Pemët kanë patur rritje të mirë vegetative, i shprehur me densitetin e degëzave të diferencuara dhe gjatësinë mesatare të tyre. Rritja vegetative është premisë e rëndësishme, sepse përbën bazën biologjike të frutifikimit të vitit pasardhës.

4.1 Prodhimi

Kultivarët kanë shprehur rezultate të mira të rendimentit kg/rr në tre fushat e studimit në Novoselë, Mifol dhe Trevllazër. Prodhimi i shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë kurorën e pemës. Madhësia e frutave është konform standartit varietor në vendin e orgjinës përsa i përket diametrit (D) dhe (d), si dhe peshës mesatare të frutit. Pjekja e frutave për vitin e dytë të studimit ka filluar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, rreth 15 ditë më përpara. Temperaturat e larta për një periudhë të gjatë kohore si dhe mungesa e rreshjeve për një periudhë 5 mujore (maj-shtator), janë arsytet për një pjekje të parakohshme të prodhimit.

Prodhimi për kultivarin Koroneiki për vitin 2017, është i ndryshëm në të tre parcelat e marra në studim. Në Novoselë rendimenti është 40 kg/rr ndërsa në Mifol është 34 kg/rr dhe në parcelën në fshatin Trevllazër prodhimi ishte 35 kg/rr.

RAPORT VJETOR 2018

Prodhimi për kultivarin Koroneiki për vitin 2018, është i ndryshëm në tre parcelave të studimit. Në Novoselë rendimenti është 27.8 kg/rr ndërsa në Mifol është 28.3 kg/rr. Në parcelën në fshatin Trevllazër prodhimi ishte 45 kg/rr.

Prodhimi mesatar për të dy vitet (2017-2018).


Novoselë 33.9 kg/rr; Mifol 31.1 kg/rr; dhe në Trevllazër 35 kg/rr.

Prodhimi për kultivarin Arbequina për vitin 2017, në tre parcelave e studimit. Në Novoselë rendimenti është 44 kg/rr ndërsa në Mifol është 39 kg/rr.

Prodhimi për kultivarin Arbequina për vitin 2018, është i ndryshëm në të tre parcelat e studimit. Në Novoselë rendimenti është 32.8 kg/rr, në Mifol është 28.3 kg/rr dhe në parcelën në fshatin Trevllazër prodhimi ishte 27.5 kg/rr.

Prodhimi mesatar për të dy vitet (2017-2018).

Novoselë: 35.9 kg/rr; Mifol: 33.6 kg/rr dhe në Trevllazër 29 kg/rr.



Grafikë 1; 2. Prodhimi mesatar për të dy vitet Koroneiki; Arbequina.

Për të tre parcelat janë kryer punët të njëjtat shërbime gjatë viteve 2017- 2018. Shpenzimet për secilën parcelë janë mbajtur në mënyrë kronologjike.

Ndryshimet për prodhimin mesatar për të dy vitet për kultivarin Koroneiki nuk janë të dukshme pasi prodhimi për kg/rrw është pothuajse i njëjtë. Diferenca e sasisë së prodhimit është në varësi të numrit të rrënjëve për njësi sipërfaqe.

1.2 Shpenzime për parcelat

Tabelë. Shpenzimet mesatare (2017-2018), të kryera për të tre parcelat e marra në studim.

Nr.	Parcelat	Fuqi punëtore për të dy vitet	Puneme mekanike	Baza materiale	Totali
1	Parcela Novoselë	109.300	12.100	11.500	132.900
2	Parcela Mifol	110.100	11.200	12.000	133.300
3	Trevllazër	55.000	9000	11000	75.000

Tabelë. Numri mesatar i ditëve të punës harxhuar për sasinë e prodhimit të marrë (2017-2018).

Nr	Proçeset e punës	Numri i ditëve mesatare të punës sipas parcelave		
		Novoselë	Mifol	Trevllazër
1.	Punim me bel 9 m ² nën kurorë	12	7	6
2.	Krasitje	6	10	3
3.	Plehim 12 kg për rrënjë	2	1	0.5
4.	Ujitje 2 herë	8	6	3
5.	Vjelje prodhimi	50	45	28
	Totali	78	69	40.5

RAPORT VJETOR 2018

Sasia e ditëve të punës në tre parcelat e marra në studim është e ndryshme, kjo pasi dhe për vet numrin jo të njëjtë të bimëve që ato kanë.

Në parcelën në Novoselë fermeri ka harxhuar 78 ditë pune, në parcelën e Mifolit fermeri ka harxhuar 69 ditë pune dhe në parcelën e Trevllazerit fermeri ka harxhuar 40.5 ditë pune. Kjo tregon se fermerët kanë një numër relativisht të vogël bimësh ulliri dhe vetëm një pjesë të kohës harxhon për këtë parcelë duke patur mundësi për t'u marrë me punë të tjera gjatë vitit dhe për të rritur të ardhurat.

Tabelë. Sasia mesatare e vajit marrë nga parcela Novosolë (2017-2018)




Novoselë	Kultivari	Prodhimi mesatar kg	% Vaji	Sasia e vajit lt
1.	Koroneiki	2034	14.3	142.2
2.	Arbequina	2513	14.5	364.3

Tabelë. Sasia mesatare e vajit marrë nga parcela Mifol (2017-2018)

Mifol	Kultivari	Prodhimi mesatar kg	% Vaji	Sasia e vajit lt
1.	Koroneiki	2177	19.3	112.8
2.	Arbequina	2688	18.6	144.5

Tabelë. Sasia mesatare e vajit marrë nga parcela Trevllazër (2018)

Mifol	Kultivari	Prodhimi mesatar ne kg	% Vaji	Sasia e vajit (lt)
1.	Koroneiki	1400	22	63.6
2.	Arbequina	1160	21.5	53.9



Grafikë. Prodhimi mesatar i vajit në cv. Koroneiki dhe Arbequina (2017-2018)

RAPORT VJETOR 2018

Prodhimi më i madh ishte në varietetin Arbequina në Novoselë me 35.9 kg/rrënjë.

Përsa i përket sasisë së vajit të marrë nga dy kultivarët ajo është e ndryshme. Rezultat më të mirë për të dy kultivarët ka dhënë zona e Novoselës për kultivarin Koroneiki ndërsa përsa i përket përqindjes (%) së vajit më të lartë e ka zona e Trevllazërit për të dy kultivarët.

Tabelë. Të ardhurat mesatare për dy vite (2017-2018)

Parcelat	Sasia e vajit	Çmimi/kg	Totali i Shitjes
Novoselë	506.5	800	405.200
Mifol	257.3	800	205840
Trevllazër (viti 2018)	117.5	800	94.000

Shpenzimet dhe fitimi

Parcelat	Të ardhurat	Shpenzimet	Fitimi
Novoselë	405200	93600	311600
Mifol	205840	82800	123040
Trevllazër (viti 2018)	94000	48600	45400

Duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet për parcelat e marra në studim kultura e ullirit është bujare në drejtim të “fitimit”, pasi të jep mundësinë që vetëm një pjesë të kohës së punës në perioda të caktuara t’i shërbesh duke lënë hapësira për të shfrytëzuar kohën tjetër për kultura të tjera dhe duke rritur më tepër fitimet e fermës.

Konkluzione

- Studimi i dy kultivarëve Koroneiki dhe Arbequina në tre zonat vërtetuan ndryshime të rendimentit, prodhimit, sasisë së vajit si dhe përqindjes së vajit.
- Prodhimi mesatar për të tre zonat e marra në studim për të dy kultivarët ishte i ndryshëm dhe pse shërbimet u kryen të njëjta për të tre parcelat. Kjo për arsye dhe të faktoreve të tjerë si struktura e tokës, ekspozicioni i parcelës si dhe pozicioni i saj (fushë ose kodër).
- Rrezja e vajit në përqindje (%), në vitet e marra në studim ishte e ndryshme në tre zonat e studimit. Zona me përqindje më të lartë të vajit ishte zona e Trevllazërit.
- Fitimi më i lartë për të dy kultivaret ishte zona e Novoselës.
- Në përgjithësi duke gjykuar mbi rezultatet e rendimentit dhe prodhimit të të dy kultivarëve në të njëjtën ambient nivel më të lartë performance ka paraqitur kultivari Arbequina.

Rekomandime

- Nisur nga të dhënat e studimit rekomandojmë:
- Shtimin e sipërfaqes së mbjellë me kultivarët Arbequina dhe Koroneiki, pasi janë kultivarë që shkojnë mirë në këto zona. Rendimenti i prodhimit dhe përqindja e vajit janë të konsiderueshme duke u bërë burim fitimi për fermerët.

Rezultati 2: Vlerësimi i produktit përfundimtar (vaj) të kultivarëve autokton të ullirit në Shamogjin (efiçenca ekonomike). Viti i dytë 2017-2018


RAPORT VJETOR 2018

Eksperimenti është kryer në ullishtet-koleksionet e QTTB Vlore. Për qëllime eksperimentale kultivaret e marra në studim janë mbjelle në Bazen Eksperimentale prodhuese të ATTC Vlora. Nga tre kultivare të marra në studim dy janë autoktone një është e huaj. Kultivari autokton Kalinjot është tipik i zonës së jugut të Shqipërisë, kultivari Ulli i bardhë i Tiranës është tipik i zonës së Shqipërisë së mesme dhe kultivari Arbequina i huaj por që ka përhapje të gjërë në Shqipëri vitet e fundit. Për përcaktimin e cilësisë së vajit të ullirit të tre kultivareve është zbatuar metoda e COI/T.20/Doc. n° 29/ Rev.1 Mostrat e analizuar treguan një përmbajtje të acideve yndyrore të cilat rezultojnë brenda standartit të përcaktuar nga IOOC/BE dhe legjislacioni shqiptar VKM Nr 235/2017, për kategorinë “vaj ulliri ekstra i virgjër”.

Rezultatet e marra vërehet një ndryshim në përmbajtje të polifenoleve në varësi të varietetit dhe në varësi të cilësisë së vajit.


Analizat me metodën e HPLC

Polifenole- Kultivar Arbequina



RAPORT VJETOR 2018

Polifenole –Kultivar Kalinjot




RAPORT VJETOR 2018

Polifenole- Kultivar Ulli i Bardhe i Tiranës.

RT: 5.24 - 29.52

NL:
1.82E4
UV_VIS_1
UV_UBT



	Arbequina	Kalinjoti	Kalinjoti 2	UBT Tiranë
Polifenole totale mg/kg	51	636	640	181

Polifenole totale realizuar me metoden e spektrofotometrise.

Analizat fiziko-kimike

	Arbequina	Kalinjoti	UBT Tiranë
Aciditeti si ac oleik (%)	0.83	0.27	0.82
Numri i Peroksideve (mekO2/Kg)	8.5	6.32	8.38
Absorbanca UV			
K232	2.0015	1.8076	1.9815
K270	1.1737	0.1359	0.1575

Rekomandime

Duke qenë se vaji i ullirit është një produkt me vlera shumë të larta ushqimore, rekomandohet që studimi rreth këtij të produkti të vazhdohet duke kaluar në studimin më të detajuar të komponimeve sekondare të cilat paraqesin karakteristika cilësore dhe të

RAPORT VJETOR

2018

natyralitetit për vajin e ullirin. Kultivaret e mare ne studim jane te kategorise ekstra te virgjere. Cilesia e vajrave eshte rezultat i vjeljes me dore nje metode me epersi per cilesine e vajit; vjelje ne kohen e duhur- ne momentin e larosjes; perpunimi i ullirit eshte bere ne makineri te paster dhe brenda kushteve teknike.

Bibliografi

Agbiolab 2009 Polyphenols and antioxidant on olive oil

www.agbiolab.com/files/agbiolab_polyphenols

Alter M, Gutfinger T (1982) Riv Ital Sost Grasse 59:14

Amiot M.J, Fleuriet A, Macheix J.J, Journal of Agriculture and Food Chemistry. 1986, 34, 823–826.

Angerosa F., Mostallino R., Basti C., Vito R.: (2000) Virgin olive oil odour notes: their relationships with volatile compounds from the lipoxygenase pathway and secoiridoid compounds. Food Chemistry., 68, 283–287.

Barranco D. de Toro C. y Rallo, L.(1998). Eporas de maduracion de cultivares de olivo en Cordola. Investigacion Agricola: Produccion y Proteccion vegetal, 13(3), 359-368. **Bartolini, G.**, Prevost G, Messeri C & Carignani G, (1998). Olive germplasm: Cultivars and world-wide collections. FAO Rome.

Beltran G, Paz Aguilera M, Del Rio C, Sanchez S, Martinez L, Influence of fruit ripening process on the natural antioxidant content of Hojiblanca virgin olive oils. Food Chemistry 2005, 89, 207–215.

García A, Brenes M, Martínez F, Alba J, García P, Garrido A: High-performance liquid chromatography evaluation of phenols in virgin olive oil during extraction at laboratory. Journal of American Oil Chemists Society. 2001, 78, 625–629.

Giovannini. C., Straface. E., Modesti. D., Coni. E., Cantafora. A., De Vincenzi. M., Malorni. E., Masella. R., (1999). "Tyrosol, the major olive oil biophenol, protects against oxidized-LDL-induced injury in Caco-2 cells". Journal of Nutrition. 129 (7): 1269–77.

Rezultati 3: Ndikimi i ujitjes së ullishtes në përmirësimin e treguesve fiziko-kimik dhe organoleptik të vajit të ullirit në kultivarin Leccino.

Qellimi: Kultivari i ullirit “Leccino” vitet e fundit është një ndër kultivarët më të kërkuar nga fermerët për vetë cilësitë e mira që ka si: Prodhim të përvitshëm dhe të bollshëm, qëndrueshmëri të lartëndaj sëmundjeve, vaj me cilësi të lartë etj.

Në QTTB Vlorë janë bërë studime të ndryshme për mënyrat e kultivimit të ullirit në drejtim të rritjes së prodhimit, të shmangies së periodicitetit, nëpërmjet krasitjes, plehrit, ujitjes, menaxhimit të tokës.

Në këtë studim do të vlersojmë ndikimin që ka ujitja jo vetëm në rritjen e prodhimit të ullirit por veçanërisht në cilësinë e vajit

Vendi i ngritjes së studimit: Baza eksperimentale prodhuese Shamogjin.

Metodika që u përdorë:

Ullishtja ku u ngrit prova e ujitjes është e moshës 8 vjeçare, Kultivari “Leccino”.

Ekspozicioni i rreshtave: Jug- Veri, në kodër, distanca e mbjelljes: Bima nga bima 5 m, rreshti nga rreshti 5m

U kryen ujitjet në periudha kohore të ndryshme sipas provave më poshtë:

V1 – Kontrolli (dëshmuesi) pa ujitje.

V2 – 1 Ujitje në muajin qershor (15 ditëshi II-të)

V3 – 2 Ujitje (qershor; korrik)

V4– 3 Ujitje (qershor; korrik; gusht)

RAPORT VJETOR 2018

Si normative uji meqënëse kemi të bëjmë me ullishte të re (viti 8-10), u përdorë 100 m³ për çdo ujitje ose 100 litra/bimë për secilën ujitje.

U kryen të gjitha ujitjet sipas metodikës por ky studim nuk u finalizua pasi nuk arritëm të mernim prodhim dhe të relizonim kryerjen e analizave të vajit.

Për vitin 2018 prodhimi i ullirit pësoi një rënie të ndjeshme. Lagështia e vazhdueshme në muajt e lulëzimit të pemës së ullirit (prill dhe maj), krijuan kushte të papërshtatëshme për frutifikim. Në fillim të muajit qershor e në vazhdim kushtet atmosferike ndryshuan totalisht duke ofruar një thatësi të tejzgatur e cila ndikoi fuqishëm në rrëzimin e frutave. Nga analizat për infeksionin aktiv në kokërr mbas datës 20 qershor, u vërejtën se infeksionet ishin të larta deri në 36% për kultivarët Lacino dhe Frantoio. Rrëzimi i frutave vazhdoi edhe gjat muajit Gusht dhe Shtator pasi këtë vit Miza e ullirit (*Bractrocea olea*) shfaqti më shumë se tre brezni. Kjo bëri që në këta dy kultivarë të kemi një humbje shumë të madhe të prodhimit. Në parcela të vecanta nuk u arrit të merrej fare prodhim.

Ky është një studim për të cilin fermerët kanë interes prandaj do të vazhdoj gjat vitit 2019.

Foto ulli i rrëzuar nën kurorën e pemës



Laboratori i analizave të ADN-së ka realizuar si më poshtë:

1. Ekstraktimi i ADN-së nga mostra të ndryshme ulliri me metodën në azot të lëngshëm

Në analizë u morrën mostra të ndryshme ulliri Kalinjot, Ulliri i Bardhë i Tiranës dhe Frantoio, nga Koleksioni i Bazës Eksperimentale/Prodhuese Shamogjin. U përdor metoda më e përshtatshme për ekstraktimin e këtyre mostrave ekstraktimi i ADN-së me azot të lëngshëm.

Peshimi i mostrave gjethore nga ulliri dhe ekstraktimi i tyre me azot të lëngshëm



Sipas protokollit, në kapën e ekstraktimit u shtua 750 µl përzierje kloroform/isoamilik (24:1) në secilin prej ependorfeve me mostrat përkatëse. Mostrat u centrifuguan në 14.000 rpm për 10

RAPORT VJETOR 2018

minuta në 4° C dhe më pas u transferua në tuba sterile (1.5 ml), duke evituar në çdo rast papastërtitë (u përdorën maja me hapje të gjerë për të shmangur dëmtime të mundshme të ADN-së). Kur ADN-ja precipitohet, u centrifuguan në 14.000 rpm për 5 minuta dhe u largua supernatanti (Ndërkohë u nxorrRNAza nga ngrirja) dhe supernatanti u eliminua. U ndoq protokollin për mostrat e përfutuara të ADN-së u ruajtën në -20°C derisa u përcaktua cilësia dhe sasia e ADN-së ekstraktuar në çdo mostër.


2. Matja e sasisë dhe cilësisë së ADN-së së ekstraktuar me metodën spektrofotometrike.

Mostrat e ekstraktuara u nxorrën nga akulli dhe u lanë për pak minuta në temperaturë ambiente për të shkrirë. Për të vlerësuar pastërtinë e ADN-së u zbatua protokollin I ekstraktimit me metodën e ekstraktimit. Duke qenë se procesi i ekstraktimit u realizua në mungesë të DTT, një reagent ky i cili përdoret për denaturimin e proteinave duke reduktuar lidhjet e tyre disulfide për të lejuar kështu ndarje më të mirë të proteinave gjatë elektroforezës, ishte e pritshme marrja e një vlere më të vogël se 1.8 nga raporti i dy gjatësive të valëve, duke treguar kështu kontaminimin e ADN-së prej sasisë së madhe të proteinave.



3. Analiza gjenetike me anë të teknikës PCR. Realizimi i hapave të teknikës PCR në mostra të ndryshme ulliri .

Mostrat e ADN-së sipas protokollit iu nënshtuan metodës së PCR-së. Pasi bandat e ADN-së u ndanë, paisja u fik, xheli u mor me kujdes prej vasketës dhe u vendos në transiluminatorin UV për t'u vizualizuar bandat e pranishme në të. Në mungesë të primerave, amplifikimi i mostrave nuk u krye por u kalua në hapin pasardhës ku ADN-ja thjesht u ngjyros me loading dye, ishte e pritshme mos-marrja e produkteve të amplifikimit gjatë vizualizimit të xhelit në transiluminator.

Vizualizimi i bandave të ADN-së



Purifikimi i ADN-së



Objektivi III.3. Kërkim në fermë. (Kërkimet në Ferme Aneksi 2.)

RAPORT VJETOR 2018

1. Ndikimi i formave të mbajtjes së lajthisë në cilësinë e prodhimit-Gjirokastrë (viti i parë).
2. Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat-Sarandë, viti i dytë i studimit.
3. Përmirësimi i cilësisë së prodhimit nëpërmjet krasitjes në rrushin e tavolinës (viti i parë) Vlorë.
4. Ndikimi i kohës dhe shkallës së reduktimit të vegjetacionit në treguesit sasior e cilësor të prodhimit të hardhisë (viti i dytë), në rrethet Tiranë, Berat e Vlorë.

Objektivi III. 4: Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teoriko-praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.

Trajnime dhe seminare me ekstensionistët	Drejtori e Bujqësisë
Kultivimi i boronicës.	
Mjedra dhe format e kultivimit të saj.	
Mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit për boronicën.	
	Tiranë
Agroteknika e kultivimit të luleshtrydhes, mjedres dhe kiwit.	
Alternativat e zgjidhjes së problemit të ngricave.	
Format, mënyrat e krasitjes dhe mbrojtja e agrumeve nga sëmundjet dhe parazitët.	
Krasitja e rëndë dhe ripërtëritëse në ullishtet shekullore.	
Mbrojtja e ullirit nga sëmundjet dhe parazitët.	
Agroteknika e kultivimit të kultivarëve të rrushit për tavolinë në fushë dhe serrë, mbrojtja e tij nga sëmundjet	
Rrallimi i veshulëve të rrushit, mënyrat dhe koha e rrallimit. Ndikimi i tyre në sasinë dhe cilësinë e prodhimit.	
	Gjirokastrë
Alternativat e zgjidhjes së problemit të ngricave për agrumet.	
Metodat e shtimit dhe mbjelljes së frutave minore.	
Kultivimi i rrushit për tavolinë.	
Çertifikimi i fidanëve drufrutorë.	
	Fier
Rëndësia e vjeljes së ullirit dhe ndikimi në cilësinë e vajit.	
Përdorimi i biorregullatorëve në vreshtari.	
Alternativat e zgjidhjes së problemit të ngricave për kulturën e agrumeve.	
Metodat e shtimit të fidanëve të çertifikuar	
	Durrës
Mbrojtja e ullirit nga sëmundjet dhe parazitët.	
Mbrojtja nga sëmundjet e pemëve bërthamore.	
Përdorimi i biorregullatorëve në vreshtari.	
	Vlorë
Teknikat e krasitjes së hardhise sipas kultivarëve dhe destinacionit të prodhimit.	
Plehrimi i gjelbër në kulturat drufrutore dhe vresht.	

RAPORT VJETOR 2018

Alternativat e zgjidhjes së problemit të ngricave për kulturën e agrumeve.

Trajnime në Drejtoritë e Bujqësisë.




Drejtoria e Bujqësisë Gjirokastër



Drejtoria e Bujqësisë Kukës



Drejtoria e Bujqësisë Tiranë



Drejtoria e Bujqësisë Vlorë

Trajnim jashtë vendit:

Trajnim i kryer ne CIHEAM Bari të Italisë në kuadër të Projektit ASDO. Improving know-how sources and extension tools -module 2 Phase 1 training of trainers in Italy.

Specialist të QTTB Vlorë pjesë në trajnim një javor me qëllim rritjen e kapaciteteve për fushën e ullishtarisë.



8. Aktivitetet kryesore:

- Studim i përshtatshmërisë së kultivarëve të rinj të shegës;
- Studim i përshtatshmërisë së kultivarëve të boronicës e mjedrës;
- Studimi morfologjik i kultivarëve të shegës autoktone;

RAPORT VJETOR 2018

- Shtimi i boronicës dhe mjedrës;
- Marja e materialit për shtim të boronicës dhe mjedrës në vendorigjinë;
- Shtimi me teknikën *in vitro* i disa nënshartesave të reja të kultivarëve drufrutorë bërthamorë (pjeshkë, kumbull, qershi);
- Monitorimi i koleksioneve të pemëve frutore, ullishtave, agrumeve dhe hardhisë në Bazën Eksperimentale/Prodhuese;
- Marrja e kampioneve të bimëve që shfaqin simptoma të sëmundjeve në kulturat drufrutore;
- Mirëmbajtje e koleksioneve dhe parcelave “mëmë” në Bazën Eksperimentale.;
- Studimi i përshtatjes së kultivarëve të limonit ndaj kushteve ambientale të koleksionit në Bazën Eksperimentale/Prodhuese të Shamogjinit (BEP);
- Vlerësimi i afinitetit në mes të nënshartesave më të rëndësishme me kultivarët kryesorë të agrumeve. Studimi i mundësisë së përdorimit të tyre në rritjen e përshtatshmërisë së bimëve të agrumeve ndaj kushteve tokësore të terreneve të zonës.

9. Mënyra e divulgimit të rezultateve:

Rezultatet janë përcjellë nëpërmjet organizimit të takimeve me specialistë të fushës, dhe fermerë kultivues të drufrutorëve, në parcelat e Bazës Eksperimentale/Prodhuese të QTTB Vlorë por edhe në ferma sipas rastit. Fokusi i punës kryesisht kanë qenë testimi i kultivarëve të mjedrës, shëgës e boronicës nëpërmjet organizimit të takimeve, me kultivues e prodhues dhe tregtar të fidanave të këtyre kulturave. Janë botuar dhe shpërndarë gjatë takimeve materiale të ndryshme divulgative si broshura, karta teknologjike, fletëpalosje. Realizimi i emisioneve dhe bisedave në TV Kombëtare e lokale dhe janë publikuar aktivitetet në rrjete sociale si facebook, Twiter.

10. Përfituesit nga projekti:

Përfituesit direkt:

Projekti është sinkron me strategjinë e MBZHR për zhvillimim e bujqësisë dhe mbështetjen për rritjen e produktivitetit të prodhimit bujqësor.

Përfituesit kanë qenë fermerët të cilëve ju është ofruar teknika e teknologji bashkëkohore mbjelljeje e kultivimi i drufrutorëve. Teknologjitë e avancuara në prodhimin e produktit final për rritjen e cilësisë.

Përfitues është stafi i QTTB Vlorë, nëpërmjet rritjes së shkallës së kualifikimit dhe specializimit të punonjësve, në fushën e vlerësimit të inputeve, teknikave dhe teknologjive bashkëkohore.

11. Rreziqet eventuale që parashikohen për mosrealizim të objektivave:

Në kushtet e QTTB-Vlorë ku financimi nga buxheti i shtetit është i garantuar, implementimi i këtyre objektivave është realizuar në bazën prodhuese të vet institucionit, ku nuk ka patur asnjë rrezik për mosrealizim.

12. Tabela e Produkte të planifikuara sipas komponentëve

Nr	EMËRTIMI	
1	Seminare me extensionistë	5
2	Ditë fushore - demonstrime	5
3	Trajnime	15

RAPORT VJETOR 2018

4	Botime gjithsej	
	a- artikuj problemorë	10
	b- fletë - palosje	2
	c- libra - broshura	2
5	Pjesëmarrje në konferenca	
	a- brenda vendit	2
	b- jashtë “	4
	c- organizim konferenca	2
6	Karta teknologjike	
	a- të reja	4
	b- të përmirësuara	
7	Studime të kryera	13
8	Emisione në RTV	8
	a- në mediat kombëtare	1
	b- në mediat lokale	7
9	Numri i specialistëve	

16. Botime

a. artikuj problemor



- Këshilla për ndikimin e ngricave në agrume
- Këshilla për fermerët që merren me kultivimin e pemëve frutore/
- Përmbledhje e Workshop "Zhvillimi i fidanishteve në Shqipëri"
- Produktiviteti apo rrezja e vajit është primare në prodhimin e vajit të ullirit
- Këshilla mbi shërbimet e stinës në frutikulturë.
- Këshilla mbi shërbimet e stinës në frutikulturë.
- Pse duhet të kultivojmë mjedrën e boronicën.
- Shërbimet agroteknike në Pemetari për muajin shtator.
- Këshilla për kohën dhe menyrat e vjeljes së frutave.
- Promivimi i vererave autoktone.
- Kultivimi i Aronias.

b. libra për ekstension

- Kriteret teknike të ngritjes së pemëtoreve të reja (hartimi i projektit për mbjelljet e reja dhe preventivat për 1 ha të specieve drufrutore)
- Pemetaria Alternative (boronica, mjedra e fruta të tjera pylli).

RAPORT VJETOR 2018



c. buletin shkencor i QTTB Vlore.



17. Pjesëmarrje ne Simpoziume, Konferenca etj Konferencë e Bioteknologjisë

International Conference on Applied Biotechnology” (3rd ICAB) Department of Biotechnology of the Faculty of Natural Sciences, organizes the Scientific Conference: 23-24 Novembre 2018 Tiranë



E. Papakosta. “In vitro Rooting of Gisela 5 (*Prunus cerasus* × *P. canescens*) Cherry Rootstock

Konferenca e Biodiversitetit me tre artikuj. XIIIth International Symposium Tirana. Biodiversity and Sustainable Development

- 1.Efekti i trajtimit me Giberelina në rregullimin e ngarkesave me fruta të bimëve të pjeshkës për përmirsimin e cilësisë së prodhimit
- 2.Mikroshumimi in -vitro i species (*Myrtos Communis*)
- 3.Mbrojtja e ullirit nga miza (*Bractocera olea*) me produkte të mbrojtjes së bimëve miqësore për shëndetin dhe mjedisin.



RAPORT VJETOR 2018

QTTB Vlorë prezantoi Aktivitetin e institucionit në takimin e Projektit Focus- Programi INTERREG Balkan. Në këtë takim Titullari prezantoi ofrimin e shërbimeve mbështetese të SME-ve . Partneret ndërkombetare vizituan Qendren e Trasferimit të Teknologjive Bujqesore, laboratorin invitro. Procesi i degustimit të vajit të ullirit dhe testimi i pastes se ullirit prodhuar i dhane vlere të shtuar këtij aktiviteti ndërkombetar.



Në 30 tetor 2018 QTTB Vlorë mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar “Cooperating for agro-food companies Innovation. Experiences, models and future developments of the European Partnership for Innovation- Operational Groups (OGs)” of #FILA, two-year project financed by the Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro aimed to strengthen and empower cross-border innovation networks through Fertilization Innovation Labs in Agro-food for improving the connection between research and SMEs (EIP approach)



18. Aktivitete të zhvilluara.

Festa e ullirit në Lukovë-Sarandë. QTTB Vlorë mori pjesë në Festën e Ullirit në Lukovë, organizuar nga bashkia Himarë në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për bashkëpunim GIZ. Ky aktivitet zhvillohet në vijim të aktiviteteve promovuese të potencialeve dhe prodhimit lokal vendas nën brandin South inspires you-Jugu të frymëzon. Ky ishte një aktivitet i hapur me pjesëmarrjen e prodhuesve lokale dhe jo vetëm, qytetare të ardhur nga zona të ndryshme të vendit, turiste të huaj dhe banorët vendas, të cilët u bënë pjesëmarrës të aktiviteteve të ndryshme.

RAPORT VJETOR 2018

Ne Projektin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për realizimin e furnizimit me fruta të shkollave, kontribuoi QTTB Vlorë në shkollat: “24 Maji”, “Jani Minga” dhe “Ismail Qemali” në Vlorë. Fruta të freskëta në shkollë, një iniciativë interesante e Ministrisë në bashkëpunim me World Vision, që synon të shpërndajë fruta të freskëta të sezonit, dy herë në javë në shkollat tona. Filluam nga Vlora dhe Korca për të cuar këtë projekt në të gjitha shkollat. Domosdoshmëri edukimi i të ushqyerit shëndetshëm dhe në ekuilibër që në moshë të vogël, për të krijuar një kulturë të re për ushqimin.




Takim me partneret e Projektit Bilateral Itali-Shqiperi. Eksperte te Institutit IVALSA Itali, Akademia e Shkencave Tirane dhe Fakulteti i Shkencave te Natyres Tirane.



Praktika mësimore me studente të Universitetit Ismail Qemali Vlorë, Universiteti Bujqesor Tirane, Universitetit Reald Vlorë, Universiteti “Fan Noli” Korçe. Këshillime & asistencë teknike fermerëve që kultivojnë kulturat drufutore.


QTTB Vlore mori pjese me produkte te saj ne Panairin “Shqiperia punon token”



19. Vizibiliteti

RAPORT VJETOR 2018

Specialistë të QTT Vlorë kanë dhënë në intervista dhe kanë zhvilluar emisione në Televizione Kombëtare e lokale të cilat kanë paraqitur interes për fermeret dhe specialistët e bujqësisë. Emisionet kanë qënë në drejtim të zhvillimit të fi danishteve në Shqipëri, zhvillimit të kulturës së ullirit si dhe aktivitetet e QTTB Vlorë.



Top Chanel - Emisioni "Në shtëpinë tonë".

TV Top Channel Emisioni: Në shtëpinë tonë "Aktiviteti i QTTB Vlorë"

TV Top Channel Emisioni: Në shtëpinë tonë "Kultivarët e kajsisë"

TVSH Emisioni: Hapësirë e blertë "Aktiviteti i QTTB Vlorë për ullirin"

Report TV "QTTB Vlorë Ullinj të Vlorës"

ONE TV -Intervistë mbi Workshop "Zhvillimi i fidanishteve në Shqipëri"

TV 6+1 Vlora -Intervistë "Ullinj të Kaninës"

TV 6+1 Vlora: "Dita e sheges"

TV 6+1 Vlora- Intervistë: "Workshopin Zhvillimi i fidanishteve"

20. Projekte me BE-ne.

➤ **Projekti bilateral Shqipëri-Itali**

"Zbatimi në shkallë të gjerë i teknikës inovative të mikroshumimit të specieve drufrutore në kulturë *in vitro* likuide të zhytjes temporane me sistemin bioreaktor (Elec-TIS)"

Partnerë bashkëpunëtorë:

CNR- IVALSA Firenze, Akademia e Shkencave, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë.

➤ **Projektit: Interreg IPA II Cross-Border Cooperation Programme, Greece- Albania 2014-2020; OLIVE-CULTURE;**

"Contribution to the enhancement of olive sector by promoting certified good cultivation practices, applying precision agriculture technologies, creating innovative local products and supporting relevant SMEs"

Partner:

Municipality Of Nicolaos Skoufas; Technological Educational Institute Of Epirus – Special Account For Research Funds - Department Of Agricultural Technology; Ionian University -

RAPORT VJETOR 2018

Research Committee – Department Of Informatics; Regional Council Of Vlora; Agricultural Technology Transfer Center Of Vlore; Municipality Of Berat.

Jane aplikuar 4 projekte ne Thitrrjen *Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH)* nga Agjencia kombëtare e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Titujt e projekteve jane:

1. Analizë e shprehjes morfologjike të tipareve gjenetike të boronicës në shqipëri dhe krijimi i kultivarëve të rinj me vlera më të larta prodhuese.
2. Analizë e shprehjes morfologjike të tipareve gjenetike të shegës shqiptare dhe krijimi i kultivarëve të rinj me vlera më të larta prodhuese.
3. Shëndetësimi me teknika in- vitro i disa kultivarëve autoktonë të hardhisë.
4. Rritja e rezistencës ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve në pemë frutore për një prodhim cilësor me përdorimin e germoplazmës autoktone.

21. Aneksi 1: Studime

22. Aneksi 2: Kerkime ne ferme.